



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:
“Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”
Universiteti “EPOKA**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Elvin GJEVORI

Dr. Gert GURI

Tetor / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master i Shkencave në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”**

1	IAL aplikues:	Universiteti “EPOKA”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në: “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 908, datë 26.08.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër MASH Nr. 565, datë 22.11.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 56, datë 28.09.2018
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	Dy vite akademike / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Angleze
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit 2022- 2023	7 PAE dhe 1 PAK Për sa i përket ngarkesës (90 % PAE- 10 % PAK)
18	Numri i studentëve:	2019-2020 9 studentë; 2020-2021 10 studentë 2021-2022 5 studentë; 2022-2023 5 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM



Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare” ofrohet nga Universiteti Epoka dhe strehohet në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Sociale si dhe Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare. Programi është licencuar fillimisht nëpërmjet VKM 908 datë 26.08.2009 dhe ka filluar veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011. Në vitin 2012 i është dhënë akreditimi i parë në përmbushje të legjislacionit në fuqi të kohës. Procesi i akreditimit periodik ka vijuar në 2018 dhe aktualisht programi i studimit po i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm periodik për herë të tretë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Statuti i Universitetit) rezulton se Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale përbëhet nga dy departamente dhe një qendër si njësi bazë. Këto departamente ofrojnë programe të ciklit të parë dhe të dytë dhe programe të ciklit të tretë të studimeve.

Programi i Studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare” ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën angleze, 120 ECTS dhe kohë zgjatje të rregullt 2 vite akademike.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare” i përket nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe sipas drejtuesve të IAL është konceptuar në përputhje me standartet dhe parimet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.

Nga takimi me studentë të këtij programi studiimi doli në pak që ata mbështën shumë nga stafi akademik dukë përfshirë studentët në punët e tyre kërkimore, organizmin e konferencave, organizimin e eventeve dhe përditësimin në të rejtat më të fundit në fushën e shkencave politike si edhe atë të integritit europian.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM:

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesë sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (ascal.al, standardet)

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga PhD. Elvin Gjevori ekspert vendas dhe drejtues i GVJ dhe Dr. Gert Guri ekspert i huaj. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Majlinda Demirneli, përfaqësuese e ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetje, të cilat u realizuan gjatë vizitës në vend. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës në institucion të zhvilluar në datat **10 dhe 11 Korrik 2023** sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga institucioni në ofrimin e një programi të mirë Master i Shkencave në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”, si edhe ofron sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të politologëve të rinj.

Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm u përcoll në Institucion më datë 22.09.2023, përmes AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 235/22, datë 22.09.2023.

Më datë 02.10.2023, përmes AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 132/13 Prot., datë 02.10.2023, Institucioni konfirmoi se nuk ka komente për Draft-Raportin. Për sa më lart, Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm kthehet në Raport Përfundimtar.

SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT



I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr. 56 datë 28.09.2018, datë janë:

1. Institucioni të shtojë numrin e moduleve të tipit A dhe lëndëve themelore, me qëllim krijimin e një baze të shëndoshë teorike për studentët vecanërisht gjatë vitit të parë të programit tëstudimit;
2. Institucioni të përfshijë në kurrikulën e programit të studimit module në informatikë dhe lëndë me zgjedhje si pjesë e aktiviteteve formuese të tipit E;

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Për rekomandimin e parë GVJ vlerëson se është **përbushur plotësisht**. Specifikisht, janë shtuar dy lëndë teorike bazë në kategorinë A, si dhe lënda e metodave të kërkimit shkencor ka kaluar nga viti i dytë në vitin e parë.

Për rekomandimin e dytë GVJ vlerëson se është **përbushur plotësisht**. Specifikisht, janë shtuar lëndë me zgjedhje të cilat zgjerojnë diapazonin e njohurive që mund të marrin studentët.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”



I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Ky program studimi është hartuar duke marrë parasysh nevojat e tregut të punës, traditën e IAL-së dhe ecurinë e proceseve integruese të vendit, dhe jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat/interesat kombëtare por i përçon ato tek brezi i ri.</p> <p>Në statutin e Universitetit Epoka i cili është i hartuar hartuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë 80/2015 dhe aktet nënligjore në fuqi, përcaktohet qartë vizionin dhe misioni i IAL që të kontribuojë në mbështetje të prioriteteve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit nëpërmjet programeve të studimit të ofruar nga ky institucion.</p> <p>Roli dhe misioni i IAL, bazuar në dokumentacionin e institucionit, është që t’u ofrojë studentëve jo vetëm një edukim cilësor akademik, por edhe të kontribuojë në edukimin e vlerave qytetare dhe demokratike të shoqërisë shqiptare.</p> <p>Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, mbështetur në Statutin dhe Planin Strategjik të IAL, synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare.</p> <p><i>Annex No. 1- Statute of EPOKA</i></p> <p><i>Annex No. 7 The Basic Regulation of EPOKA University</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit është në përputhje me zhvillimet politike jo vetëm të vendit, por të rajonit në përgjithësi, pasi një numër i konsiderueshëm lëndësh trajton proceset e demokratizimit dhe integritit evropian me tema specifike të sistemit politik, partive politike dhe sistemeve elektorale, gjeopolitikës dhe sigurisë së rajonit, politikave rajonale dhe sociale si dhe</p>

	<p>menaxhimin e projekteve etj. Programi i studimit ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e IAL-së, për formimin akademik të studentëve në fushën e studimeve të marrëdhënieve ndërkombëtare, me ndikim në rajon e më gjerë, duke ju ofruar një edukim cilësor në partneritet me institucione ndërkombëtare.</p> <p>Annex No. 1- Statute of EPOKA</p> <p>Annex No. 7 The Basic Regulation of EPOKA University</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Msc në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, është një program studimi i ciklit të dytë të studimeve i hartuar në përputhje me rregulloren e institucionit dhe të njësisë kryesore dhe planin strategjik të intucionit, që synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike dhe aftësi për kërkim shkencor në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.</p> <p>Në përputhje me Statutin, programi i studimit ka për qëllim zhvillimin e dijeve dhe përgatitjen e studentëve në nivel bashkëkohor nëpërmjet aktiviteteve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Programi i studimit synon të përgatitë specialistë të aftë dhe të kualifikuar jo vetëm në marrëdhëniet ndërkombëtare, por dhe në kërkimin shkencor. Nga analiza e dokumentacionit dhe vizita në institucion, ky program studimi është në përputhje të plotë me sa më sipër dhe ofron një shembull pozitiv se si tradita akademike dhe bashkëpunimi ndërkombëtar mund të ndërthuren në një program studimi.</p> <p>Annex No. 1- Statute of EPOKA</p> <p>Annex No. 7 The Basic Regulation of EPOKA University</p> <p>Annex No. 13- Strategic Plan 2017-2022</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë</p>	<p>Ky program pajis studentët me aftësi të mira teorike dhe praktike. Programi i studimit është në përputhje me zhvillimet madhore jo vetëm kombëtare por edhe ato rajonale pasi ofron ekspertizë specifike në lidhje me zhvillimet politike dhe proceset integruese të rajonit dhe vendit. Me hapjen e negociatave, të cilat do të jenë të gjata e me nevojë për ekspertizë teknike, të diplomuarit e këtij programi, mund të gjejnë një treg të favorshëm pune.</p> <p>Annex No. 4- Curricula of the study program.</p>

ndërkombëtar.	<i>Annex No. 5- Course Syllabi.</i>		
Konkluzione	<i>Programi i studimit ka vite që ofohet nga IAL, ka kaluar një proces të mëparshëm vlerësimi dhe është në përputhje të plotë interest kombëtare, strategjitë zhvillimore si dhe me profilin dhe dokumentat strategjitë të IAL.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht		Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me misionin, qëllimin e institucionit si dhe me strategjinë afatshkurtër dhe afatgjatë të tij duke mbajtur në konsideratë nevojat e tregut të punës dhe duke pasuaruar programin mësimor me lëndë të cilat plotësojnë nevojat për këto kërkesa.</p> <p>Programi i studimit mban në konsideratë zhvillimet integruese dhe politike të vendit. Pozicioni i Shqipërisë dhe marrëdhëniet e saj rajonale si dhe me vendet e Bashkimit Europian përditësohen dhe pasqyrohen në programin e studimit.</p> <p>IAL ka një staf të kualifikuar me tituj dhe grada si dhe me eksperiencë të gjatë akademike dhe profesionale e cila është një vlerë e shtuar e rëndësishme sidomos për një program studimit master shkencor.</p> <p>Në tërësi, programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare është përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit. Objektivat e programit të studimit janë të përshtatura dhe të integruara me strategjinë për zhvillim të institucionit të cilët janë të matshëm dhe të realizueshëm prej tij. Programi mundëson studimin teorik në fushën e shkencave politike, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë, për t'i përgatitur studentët si specialistë dhe kërkues të aftë që të punojnë në fushat përkatëse</p> <p><i>Annex No. 12- EPOKA University Strategy 2018-2022</i></p>

	<i>Annex No. 13- Strategic Plan 2017-2022</i>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare ka si objekt studimin dhe formimin teorik duke i trajtuar ato në përputhje me zhvillimet globale, sidomos në nivel evropian, dhe në përgjigje të nevojave të tregut të punës në vend dhe rajon.</p> <p>Ky program është pjesë e kurrikulës të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale dhe përputhet me fushën akademike e kërkimore të kësaj njësie kryesore. Programi përputhet me planin afatgjatë dhe afatmesëm të Universitetit Epoka, në kuadrin e prioriteteve të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.</p> <p>Ky program studimi është i organizuar në lëndë mësimore të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit është i përqëndruar kryesisht në studimin e çështjeve evropiane në aspektin e teorive të integritit, të drejtën evropiane, politikave publike, teorive të administratës, historisë së qytetërimit evropian, sistemet politike evropiane si dhe politikave sektoriale të Bashkimit Evropian.</p> <p><i>Annex No. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>GVJ konstaton se programi i studimit ofruar nga Universiteti Epoka, është një program studimi i Ciklit të Dytë me 120 kredite, i referohet nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, me formë studimi me kohë të plotë, i ofruar dhe realizuar në gjuhën angleze, i organizuar me një kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra). Në bazë të shqyrtimit të dokumentave (Rregullore e IAL dhe departamentit) konstatohet që organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje të plotë me fushat e drejtimit akademike të IAL. Objektivat e programit janë në përputhje me objektivat e Fakultetit dhe Departamentit.</p> <p><i>Annex No. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i></p> <p><i>Annex No. 7- The Basic Regulation of EPOKA University</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë</p>	<p>Nuk aplikohet</p>

profilin të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.							
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Numri relativisht i vogël i studentëve të diplomuar në këtë program studimit e bën të vështirë aplikimin e strukturuar të një politike të tillë. Gjithsesi, GVJ vereu që IAL ka një politikë të strukturuar në nivel makro për angazhimin e alumni përgjatë gjithë vitit akademik ku ofrohen dhe hapësira për zhvillim të vazhdueshëm profesional.						
Konkluzione	<i>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin të cilat kanë gjithashtu kapacitetet e duhur për ta ofruar dhe monitoruar atë.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, koMShani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Në përgjithësi, me sa u vu re nga vizita në institucion dhe takimet me aktorë të ndryshëm, IAL inkurajonte bashkëpunimin midis stafit. Duke qenë dhe universiteti është relativisht i vogël, bashkëpunimi dhe komunikimi është i natyrshëm dhe organik. Teksa universiteti zgjerohet, instancat duhet të tregojnë kujdes dhe të ndermarrin masa proaktive që ky lloj bashkëpunim të mos venitet. Marrëdhëniet midis aktorëve të ndryshëm janë të specifikuar dhe institucionalizuara në rregulloren e institucionit dhe njësisë bazë, duke mundësuar që secili aktor të dijë pritshmëritë ndaj tij.</p> <p><i>Annex No. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i></p> <p><i>Annex No. 7- The Basic Regulation of EPOKA University</i></p>

	<p><i>Annex No. 22- Regulation on student exchange</i></p> <p><i>Annex No. 23- Regulation on Staff Exchange</i></p> <p><i>Annex No. 25- List of lectures and seminars with foreign lecturers</i></p> <p><i>Annex No. 26- List of Foreign Partnership Agreements</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Institucioni ka një sërë marrëveshjesh me institucione kombëtare, publike e jo, si dhe profesionale ku studentët mund të ndërmarrin njohuri profesionale. Këto marrëveshje shfrytëzohen edhe për të përthithur zërin e tregut të punës dhe për të mundësuar përditësimin e vazhdueshëm të kurrikulës. Gjithashtu, duke qenë se ky program ka një numër të vogël studentësh, këto marrëveshje janë të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat dhe nevojat e tyre.</p> <p><i>Gjithsesi, duhet theksuar, siç do të bëhet e qartë edhe më poshtë, se mungesa e praktikës profesionale në kurrikulën e programit, e kufizon shfrytëzimin optimal të këtyre marrëveshjeve.</i></p> <p><i>Annex No. 26- List of Foreign Partnership Agreements</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, koMShani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Institucioni paraqiti një numër të konsiderueshëm marrëveshjesh në RVB dhe gjatë vizites me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, publike dhe jo, akademike dhe profesionale me të cilat bashkepunon në nivele të ndryshme dhe ku studentët mund të marrin njohuri profesionale. Marrëveshjet, me qa sa ishim ne gjendje te kuptonin nga teksti i tyre, ishin te dobishme dhe ne shërbim te ketij programi. Bazuar në këto të dhëna konkludojmë që ky kriter plotësohet.</p> <p><i>Annex No. 21- Strategic Plan on Internationalization</i></p> <p><i>Annex No. 22- Regulation on student exchange</i></p> <p><i>Annex No. 23- Regulation on Staff Exchange</i></p> <p><i>Annex No. 24- List of Students and Staff Mobility</i></p> <p><i>Annex No. 25- List of lectures and seminars with foreign lecturers</i></p> <p><i>Annex No. 26- List of Foreign Partnership Agreements</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia</p>	<p>Programi MSH në shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare ka një strategji zhvillimi i cili është bazuar në</p>

përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>analizën, në rang departamenti, mbi ecurinë e programit ndër vite. Departamenti në bashkëpunim me njësinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë, analizon problematikat e vërejtura mbi programin dhe ndërmerr hapat përkatëse. Në vizitë u informuam që në përgjethësi universiteti ka një përjasje konservatore dhe ndryshimet bëhen pas konsultimeve të gjera e të gjata dhe ndryshimet bëhen rrallë. Gjithashtu u informuam që ndryshimet përpunohen të bëhen nën kufirin 20% që të mos quhet riorganizim. Kjo qasje në fakt e ka penguar institucionin që të plotësojë në kohë të gjitha rekomandimet nga akreditimi i mëparshëm.</p> <p><i>Annex No. 12- EPOKA University Strategy 2018-2022</i></p> <p><i>Annex No. 13- Strategic Plan 2017-2022</i></p>		
Konkluzione	<p><i>LAL ka një sërë marrëveshjesh me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat, duke patur parasysh edhe numrin e vogël të studentëve, janë mëse të mjaftueshme për realizimin e komponentit praktik të programit të studimit.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e	Ky program studimi është pjesë e kurrikulës së Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Sociale. Programi përputhet me

programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).

planin afatgjatë dhe afatmesëm të Universitetit Epoka, në kuadrin e prioriteteve të Integritit të Shqipërisë në Bashkimin European. Ky program është i organizuar në lëndë mësimore të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit është i përqëndruar kryesisht në studimin e çështjeve europiane në aspektin e teorive të integritit, të drejtën europiane, politikat publike, teorive të administratës, historisë së qytetërimit evropian, sistemet politike të Evropës si dhe Politikave sektoriale të Bashkimit European.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 60 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë Në tërësi lëndët e programit janë të përshtatshme me qëllimet e programit dhe me objektivat e tij. Gjithashtu lëndët kanë tituj të përshtatshëm, të qartë dhe që përshkruajnë në mënyrë korrekte tematikën e lëndës. Ndarja në kategoritë përkatëse, ndarjet e orëve për çdo lëndë me kreditet përkatëse për çdo semestër, përcaktohen në rregulloren e programit dhe planin mësimor të tij dhe reflektojnë kërkesat e akteve nënligjore në fuqi të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.



Annex No. 4- Curricula of the study program

Annex No. 5- Course Syllabi

Annex No. 93- Summary Tables

<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe komShetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komShlekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi MSH në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare ka qëllim që të formojë specialistë me orientim teorik në fushat studimore të mësipërme. Sipas raportimeve dhe nga vizita, ishte e qartë që Universiteti synonte të krijonte specialistë me formim teorik dhe aftësi praktike që mund të integroheshin lehtësisht në tregun e punës. Universiteti gjithashtu ka angazhuar edhe një numër pedagogësh të jashtëm me eksperiencë praktike si mësimdhënës në këtë program.</p> <p>Programi synon të formojë studentë me njohuri në fushën e politologjisë, diplomacisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare të BE. Studentët që ndjekin këtë program studimi kanë mundësi të punësohen apo të vijojnë karrierën e tyre profesionale kryesisht në institucione publike qëndrore të cilat duhet të njohin strukturat/rreguloret e BE dhe harmonizohen gradualisht me to. Gjithashtu programi i mundëson studentëve të cilët kanë interes të vijojnë studimet e ciklit të tretë. Lëndët dhe veprimtaritë mësimore të programit lidhen harmonikisht me objektivat formues të programit të studimit.</p> <p><i>Annex No. 4- Curricula of the study program</i></p> <p><i>Annex No. 5- Course Syllabi.pdf;</i></p> <p><i>Annex No. 7- The Basic Regulation of EPOKA University</i></p> <p><i>Annex No. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i></p> <p><i>Annex No. 93- Summary Tables</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmblylëse.</p>	<p>Në program përfshihet teza e diplomës me 30 ECTS dhe nga viti akademik 2023-2024 do të përfshihet edhe praktika profesionale.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e</p>	<p>N/A</p>

<p>mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Studentet që ndjekin programin MSH në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombetare kanë si detyrim të kenë përfunduar studimet universitare në nivel bachelor e të kenë grumbulluar 180 ECTS.</p> <p>Pranimi i studentëve bëhet në përputhje me ligjin 80/2015, si edhe aktet nënligjore në fuqi, dhe pasi është bërë kontrolli i dosjes me dokumentacionin e kërkuar. Ky program mbështetet në njohuritë e përfituara në ciklin e parë të studimeve dhe garanton përftimin e dijeve, aftësive e shkathtësive në përputhje me nevojat e tregut të punës në fushën e politologjisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.</p> <p>Pranimi në ciklin e dytë të studimeve bëhet në përputhje me specifikat e programit, mundësitë akademike, nevojat e tregut si dhe mundësitë infrastrukturore të institucionit. Bazuar në rregulloret e programeve të studimit institucioni shpall kriteret specifik të pranimit.</p> <p><i>Annex No. 7- The Basic Regulation of EPOKA University</i></p> <p><i>Annex No. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i></p>

Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë,	N/A						
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Nuk ka ende kodifikim edhe pse VKM ka dalë në maj 2022 dhe është në proces zbatimi.						
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N/A						
Konkluzione	<i>Programi i studimit ofrohet në përputhje me kriteret/kërkesat ligjore si pjesa e përkrahjes së organizimit të programit, ndarjes në ECTS ashtu edhe kriteret e pranimit.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale (FDSHS) është njësia kryesore e cila koordinon të gjithë veprimtarinë mësimore-shkencore të shkencave juridike, shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin Epoka.

përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

FDSHS është e organizuar në 3 njësi bazë të cilat janë:

1. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare;
2. Departamenti i Drejtësisë;
3. Qendra për Studime Europiane;

Njësia kryesore dhe njësitë bazë përbërëse të saj kanë staf akademik dhe ndihmës akademik (në sasi dhe në formim me grada e tituj) në përputhje me ligjin 80/2015 dhe aktet nënligjore në fuqi.

Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale (FDSHS) në vitin akademik 2022-2023 është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (25 pedagogë PAE) dhe 14 Personel Akademik me Kontratë (PAK), të cilët kanë kualifikimin si më poshtë *Annex No. 93- Summary Tables*.

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale	
	PAE	PAK
Prof.Dr	1	2
Prof.Asoc	4	2
Dr/PhD	12	5
Msc	8	5
Gjithsej	25	14

Çdo njësi bazë është i përbërë nga të paktën 7 staf akademik, ku të paktën 3 prej tyre janë me gradë shkencore. Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Mp në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”.

Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë:

Tituj/ grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK

Prof.Dr.	-	1	-	-	-	-
Prof. Asoc.	2	2	2	2	4	-
Dr./PhD.	3	-	3	2	2	1
Msc.	3	1	3	3	3	1
Totali	8	4	8	7	9	2



Annex No. 93- Summary Tables

<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit GVJ vëren se njësia kryesore dhe ajo bazë përmbushin të gjitha detyrimet ligjore, nga pikpamja sasiore dhe përmbajtësore, për staf akademik me grada dhe tituj.</p>
---	--

<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Bazur në RVB si dhe nga vizita në institucion, GVJ vëreu se njësia kryesore, me qëllim bashkërendimin e veprimtarisë për programet master dhe mbikqyrjen e procesit mësimor ka caktuar një koordinator si përfaqësues për ndjekjen e zhvillimeve dhe problematikave të programit të studimit master. Koordinatori kujdeset për realizimin e misionit dhe veprimtarive mësimore të këtyre programeve. Duke qenë që programi ka një numër të kufizuar studentësh aktiv, ky rregullim, sipas GVJ, është i përshtatshëm dhe eficient</p> <p><i>Annex No. 7- The Basic Regulation of EPOKA University</i> <i>Annex No. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i></p>
---	--

<p>Konkluzione</p>	<p><i>Njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për zbatimin dhe mbikqyrjen e programit të studimit përmbushin kriteret ligjore për numrin e stafit me tituj dhe grada si dhe përsa i përket akteve të tjera të brendshme rregullatore.</i></p>
---------------------------	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar tek shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në dosjen e vetë vlerësimit si dhe vizitën në institucion, GVJ evidentoi se njësia kryesore dhe njësia bazë që janë përgjegjëse për këtë program studimi disponojnë dhe i vënë në dispozicion studentëve të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Kjo doli në pah sidomos nga takimi me studentët.</p> <p>Specifikisht, DFSHS organizohet në tre njësi bazë, si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none">- Departamenti i Drejtësisë;- Qendra për Studime Evropiane;- Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare; <p>Veprimtaria e fakultetit dhe e secilit prej departamenteve realizohet duke u mbështetur në aktet e brendshme të IAL dhe rregulloret e njësive bazë, në të cilat pasqyrohen misioni dhe objektivat e secilës. Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare përgjegjës për programin e studimit programon, organizon dhe bashkërendon veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.</p> <p>GVJ u informua gjithashtu në takimin me studentët gjatë vizitës në institucion se të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe lëndët i marrin nëpërmjet sistemit EIS, syllabuseve të lëndëve dhe materialeve të tjera divulgative.</p> <p><i>Annex No. 7- The Basic Regulation of EPOKA University</i> <i>Annex No. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i> <i>Annex No. 93- Summary Tables</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet</p>	<p>Bazuar në ligjin 80/2015 dhe aktet nën ligjore në fuqi, IAL ofron programe studimi të organizuara në module e të vlerësuara në kredite ECTS. Plani mësimor për programin e</p>

<p>informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>studimit në shqyrtim pasqyron zhvillimin e programit në 2 vite akademike, 4 semestra, me 120 kredite. Plani përmban informacionet për lëndët/modulet të vlerësuara me kredite sipas sistemit ECTS si dhe siguron një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mësimore ndërmjet semestrave në zbatim të udhëzimeve të MAS (4 semestra me nga 15 javë).</p> <p><i>Annex No. 1- Statute of EPOKA</i></p> <p><i>Annex No. 4- Curricula of the study program</i></p> <p><i>Annex No. 5- Course Syllabi</i></p> <p><i>Annex No. 93- Summary Tables</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Bazuar në ligjin 80/2015 dhe aktet nën ligjore në fuqi, programin e studimit mund ta ndjekin studentë të cilët zotërojnë së paku diplomën “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS.</p> <p>Procedurat e pranimit përcaktohen në aktet rregullatore të IAL, përfshirë rregulloren e programit të studimit dhe shpallen në të gjitha mjetet e informimit të institucionit. Procedurat e pranimit të studentëve realizohen nga një komision duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga MAS dhe kriteret të veçanta që vendos institucioni.</p> <p>Procedura e transferimeve përcaktohet në aktet rregullatore të IAL dhe shprehet e përmbledhur në një udhëzues të posaçëm.</p> <p><i>Annex No. 45- Student Admission ISO Procedures</i></p> <p><i>Annex No. 46- Marketing Policy</i></p> <p><i>Annex No. 47- Directive On Student Transfer</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacion mbi njohuritë që ofrohen e rezultatet e pritshme të mësimnxënies. Specifikisht, në planin mësimor të programit pasqyrohen të gjithë elementët në përputhje me aktet nënligjore në fuqi si: emërtimi i lëndës, semestri kur zhvillohet, ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit në ECTS, ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime dhe seanca të praktikave të zhvilluara jashtë auditorit, raporti leksion/seminar, ushtrime, praktika mësimore, mënyra e kontrollit të dijeve si dhe totali i krediteve.</p> <p><i>Annex No. 4- Curricula of the study program</i></p>

	Annex No. 5- Course Syllabi		
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Të gjitha njësitë kryesore dhe bazë të IAL, në koordinim me njësinë përgjegjëse për monitorimin e cilësisë, monitorojnë nëpërmjet sondazheve, vëzhgimeve e takimeve periodike cilësinë e mësimdhënies dhe kënaqshmërinë e studentëve. Gjithashtu zhvillohen edhe takime më të rralla - por periodike - me aktorët e interesuar të tregut të punës për të marrë pershtypjet e tyre mbi aftësitë e të diplomuarve dhe nevojat për përmirësime në kurrikul. Te gjitha këto informacione administrohen nga njësia bazë, e cila nëse konkludon që ka nevojë për ndryshime ndjek hapat e përcaktuara në rregullore për t'i kërkuar ato. <i>Annex No. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i> <i>Annex No. 4- Curricula of the study program</i> <i>Annex No. 100- Curriculum change procedure</i> <i>Annex No. 101- Curriculum Change Proposal Form</i>		
Konkluzione	Programi është në përputhje me kriteret ligjore, i strukturuar si dhe përmban objektiva formues të qartë e të përshtatshëm për ciklin e studimit.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, koMShetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose	Programi përmban lëndë që u mundësojnë studentëve njohuri mbi zhvillimet më të fundit në shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare në përputhje me emërtimin e programit. Lëndët - së bashku me praktikën profesionale që do të ofrohet në vitin akademik 2023-24 - i mundësojnë studentëve aftësim teorik dhe praktik për patur karrierë profesionale apo akademike në politologji, marrëdhënie ndërkombëtare apo

punësimin e studentëve.	administratë publike. <i>Annex No. 4- Curricula of the study program</i> <i>Annex No. 5- Course Syllabi</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.	Programi ka përcaktuar veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët sipas kategorive përcaktëse me ngarkesën përkatëse. Programi i studimit përmban disiplina bazë formuese-përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (A) gjithsej 15 ECTS ; karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore (B) gjithsej 45 ECTS ; ndërdisiplinore/integruese-nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) gjithsej 22.5 ECTS ; ndërdisiplinore – gjuhë të huaja, njohuri informatike (D) gjithsej 7.5 ECTS si lëndë plotësuese (E) gjithsej 30 ECTS tema e diplomës. <i>Siç e kemi thënë edhe më sipër mungesa e praktikës profesionale, edhe pse do të ofrohet në vitin akademik 2023-24, është një rekomandim i papërbushur.</i> <i>Annex No. 93- Summary Tables</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, koMShetenca dhe formim të thelluar profesional.	Praktika profesionale ende nuk është pjesë e planit mësimor të programit të studimit dhe do të ofrohet në vitin akademik 2023-24. Kjo gjë duhej realizuar më parë pasi është një rekomandim i akreditimit të mëparshëm. <i>Annex No. 4- Curricula of the study program</i> <i>Annex No. 5- Course Syllabi</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në	Raportet midis formimit teorik dhe praktik të programit të studimit burojnë nga objektivat e tij. Objektivat kryesore të programit lidhen me dhënien e njohurive kryesisht teorike mbi shkencat politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Vlerësimi me ECTS i lëndëve në programin e studimit mundëson krahasimin e njohurive mes programeve të ngjashme e lehtëson transferimin e krediteve/studimeve. Institucioni gjithashtu inkurajon mobilitetin e studentëve sidomos kur

përfundim të studimeve.	<p>financohen nga BE. Në tërësi, GVJ vëren se raportit midis formimit teorik dhe praktik u mundëson studentëve kompetenca dhe aftësi që përshtaten me kërkesat e pozicioneve të punës. GVJ vëren se me përfshirjen e praktikës në kurrikul, ky raport do të jetë edhe më i plotë dhe balancuar.</p> <p><i>Annex No. 93- Summary Tables</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e koMShetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Njësia bazë dhe njësia kryesore, në fillim të çdo viti akademik kanë një proces ku analizojnë të dhënat e përfuara nga analiza e vitit paraardhës si dhe mënyrat se si ato mund të reflektohen, ndër të tjera, në përditësimin e silabuseve. Nga analiza e dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ vëren se ky proces ishte i mirë-rregulluar dhe serioz.</p> <p>Gjithsesi, GVJ gjithashtu vëren pavarësisht shumë lëndëve me zgjedhje që janë në programin e studimit, shumica e tyre nuk aktivizoheshin pasi nuk kishte mjaftueshëm studentë.</p> <p><i>Annex No. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe koMShetencave të synuara.</p>	<p>Programi synon t'iu ofrojë studentëve aftësimin teorik dhe deri diku praktik nëpërmjet mësimdhënies dhe lidhjes me aktorët e tregut të punës që të jenë të aftë të analizojnë fenomenet e shkencave politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare me fokus në zhvillimet dhe integrimet evropiane. Programi synon formimin e specialistëve të rinj të aftë të punojnë ose të vijnë në specializim të mëtejshëm në fushat ku kanë interes e që lidhen me shkencat politike e marrëdhëniet ndërkombëtare.</p> <p><i>Annex No. 12- EPOKA University Strategy 2018-2022</i></p> <p><i>Annex No. 13- Strategic Plan 2017-2022</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Sipas ligjit të arsimit të lartë, diplomimi nga një program MSh i jep mundësinë studentit, nëse plotëson kriteret e tjera, të vijojë studimet e ciklit të tretë. Ky program studimi duke ofruar edhe trajnim të avancuar në metoda kërkimi dhe duke patur si një detyrim edhe shkrimin e temës së diplomës, i parapërgatit studentët për jetën kërkimore që duhet të ndërmarrin si doktorantë. Përsa i përket tregut të punës, jemi shprehur disa here më sipër, që programi ofron aftësi që mundësojnë punësim kryesisht në institucione qendrore publike.</p> <p><i>Annex No. 12- EPOKA University Strategy 2018-2022</i></p> <p><i>Annex No. 13- Strategic Plan 2017-2022</i></p>



Konkluzione	<i>Struktura dhe organizimi i programit të janë në tërësi në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. <u>Mungesa e praktikës profesionale është një mangësi që duhej ishte trajtuar më herët.</u></i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Universiteti Epoka ka shumë bashkëpunime me partnerë, kryesisht të institucioneve publike qëndrore. Nga bashkëpunimi me to, në mënyrë kryesisht <i>ad hoc</i>, mbledh informacion mbi përshtatshmërinë e programit të studimit dhe nevojave të tregut të punës. Po aq e rëndësishme, IAL ka marrëdhënie të strukturuar bashkëpunimi me aktorët e tregut të punës, kryesisht për praktikantë mësimorë (të programeve të tjera) dhe për të krijuar lidhje për studentët për të lehtësuar punësimin e tyre të mëtejshëm. Përsa i përket programeve mësimore, fakultetet dhe njësitë bazë zhvillojnë takime, kryesisht një herë në vit për të identifikuar nevojat e tyre dhe për t'u pëpjekur për t'i reflektuar në sylabuse të cilat 'rifreskohen' në fillim të vitit akademik.</p> <p><i>Annex No. 8- Study of the labor market after the exit of the students Annex No. 26- List of Foreign Partnership Agreements</i></p>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në	<p>Studentët janë të përfshirë në të gjitha nivelet e vendimmarrjes së IAL, nga senati deri në njësinë bazë. Nga vizita në institucion dhe analiza e DVV, GVJ gjithashtu vëreu se studentët ishin të përfshirë edhe në sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Specifikisht, GVJ vëreu se vjelja e mendimit të studentëve zhvillohet kryesisht nga Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës përmes fokus grupeve dhe takimeve të ndryshme. Gjetjet nga këto takime i</p>



<p>ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>përcillen njësisë që i përket programi.</p> <p>Në mënyrë më jo-formale, nga takimi me studentët GVJ u informua se edhe gjatë zhvillimit të procesit mësimor, pedagogët përthithin mendimin e tyre për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p><i>Annex No. 30- Rectorate Decision_ last Report_ Course Instructor Evaluation Survey Results</i></p> <p><i>Annex No. 31- Course Instructor Evaluation Survey</i></p> <p><i>Annex No. 58- Last Report related to Student Satisfaction Survey Results</i></p> <p><i>Annex No. 107- Academic Staff Satisfaction Survey</i></p>								
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Gjurmimi i studentëve alumni dhe angazhimi i tyre periodik mbikqyret nga zyra përkatëse në bashkëpunim me njësitë e tjera administrative dhe njësitë bazë në IAL. Në këtë kuadër IAL ka dhe një formular tip që plotësohet nga alumni për të krijuar dastabazën e të dhënave.</p> <p>GVJ u informua se, bazuar në përpunimin e të dhënave të marra nga formulari, IAL disponon të dhëna statistikore për punësimin e të diplomuarve, për mbledhjen e të cilave ndihmon formulari i studentit Alumni. Gjithsesi, GVJ nuk identifikoi raste specifike ku programi i studimit të ketë reflektuar sugjerimet e rrjeteve apo shoqatave të profesionistëve në silabuset apo programin e studimit.</p> <p><i>Annex No. 9- Decision of the Rectorate on Alumni Survey</i></p> <p><i>Annex No. 95- Alumni Survey Questionnaire Form</i></p> <p><i>Annex No. 96- Company Satisfaction Survey Form</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>IAL ka marrëdhënie të konsoliduara me aktorët e tregut të punës të cilët, ndër të tjera mund të angazhohen edhe në procesion e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="552 1532 743 1626"></th> <th data-bbox="743 1532 919 1626">Përmbushet</th> <th data-bbox="919 1532 1110 1626">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1110 1532 1331 1626">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="552 1626 743 1682"></td> <td data-bbox="743 1626 919 1682"></td> <td data-bbox="919 1626 1110 1682"></td> <td data-bbox="1110 1626 1331 1682" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare është në përputhje me objektivat dhe mundësitë e institucionit.</p> <p>Siç u tha më sipër, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale zotëron aftësitë programatike (stafin) që të ofrojë lëndët bazë dhe ndërdisiplinore për këtë program studimi. Gjithashtu, duke qenë që IAL është pjesë e bashkëpunimeve ndërkombëtare në fushën e shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, ky program studimi është në përputhje me objektivin e institucionit për tu kyçur në marrëveshje bashkëpunimi me IAL lider në rajon e më gjerë.</p> <p><i>Annex No. 8- Study of the labor market after the exit of the students</i></p> <p><i>Annex No. 12- EPOKA University Strategy 2018-2022</i></p> <p><i>Annex No. 13- Strategic Plan 2017-2022</i></p> <p><i>Annex No. 60- Regulation On Scientific Research</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare përbëhet nga lëndët dhe modulet e tyre të cilat kanë qëllimet, objektivat, dijet dhe aftësitë profesionale që studentët pritet të përfitojnë në përfundim të studimeve. Programi mbështetet në njohuritë e përfituara në ciklin e parë të studimeve dhe synon përfundimin e dijeve, shkathtësive e kompetencave në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p> <p>Programi synon formimin e shprehive të veçanta nëpërmjet lëndëve bazë, formuese, karakterizuese që synojnë pajisjen e studentëve me njohuri bazë shkencore dhe praktike në studimet politike dhe ndërkombëtare. Pedagogët e lëndëve i ndërtojnë vetë silabuset e tyre në bazë të udhëzimeve ligjore në fuqi e pa kufizime programatike apo përmbajtësore. Ato gjithashtu i përditësojnë ato çdo vit akademik bazuar në zhvillimet akademike dhe reflektimin e kërkesave/mendimeve të studentëve paraardhës.</p> <p><i>Annex No. 4- Curricula of the study program</i></p> <p><i>Annex No. 5- Course Syllabi</i></p> <p><i>Annex No. 8- Study of the labor market after the exit of the</i></p>

	<i>students</i>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>GVJ vëren se ky program studimi synon të pajisë të diplomuarit me njohuri teorike e metodologjike mbi shkencat politike, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe politikat e Bashkimit Evropian që mundësojnë punën e pavarur kërkimore dhe integrimin në tregun e punës. Po aq e rëndësishme, studentët janë të përfshirë edhe në një sërë shkëmbimesh në projekte Erasmus+ dhe bashkëpunime bilaterale.</p> <p>Nga vizita në institucion GVJ u informua gjithashtu se studentët marrin pjesë në konferenca studentore dhe shkruajnë artikuj në bashkëautorësi me pedagogët e tyre që është një praktikë mjaft pozitive.</p> <p>Zhvillimi i temës së diplomës është momenti kryesor kur studentët, nëse kanë dëshirë, mund të angazhohen në kërkim shkencor nën udhëheqjen e një pedagogu. Për këtë process, IAL ka struktura dhe rregullore të posaçme të dedikuara për të orientuar dhe ndihmuar studentët.</p> <p><i>Annex No. 60- Regulation On Scientific Research</i></p> <p><i>Annex No. 62- Guidelines for Research Project</i></p> <p><i>Annex No. 63- List and brief description of the acquired and implemented Research Projects</i></p> <p><i>Annex No. 64- List of Publication</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Bazuar në analizën e DVV dhe nga vizita në institucion, GVJ vëren se procesi i hartimit të buxhetit në IAL është në tërësi gjithëpërfshirës dhe bazohet sidomos në kërkesat e njëjësive bazë. Buxheti i institucionit përsa i përket strukturimit dhe zbatimit të tij, rregullohet në Statut dhe Rregulloren e IAL. Burimet financiare kryesore të institucionit janë të ardhurat nga pagesa e tarifave të studentëve, aktiviteteve me të tretë dhe financime nga projektet kryesisht ndërkombëtare.</p> <p>Duke qenë që programi ka një munër të ulët studentësh, nga pikpamja financiare ai “del me humbje” dhe mbulohet nga buxheti i IAL pasi konsiderohet si fushë prioritare kërkimore. Të gjitha aktivitetet, kryesisht mësimore, në lidhje me programin mbulohen financiarisht nga IAL.</p> <p><i>Annex No. 93- Summary Tables</i></p>



Konkluzione	<i>GVJ vëren se programi i studimit është në përputhje me objektivat e institucionit, menaxhohet me efektivitet nga njësia bazë dhe ka në dispozicion burimet e nevojshme për të qenë efektiv.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.7

Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>Ky është një kriter të cilin institucioni dhe programi e përmbushin plotësisht. Institucioni dhe njësia bazë kanë një program të strukturuar mbështetje dhe inkurajimin financiar për kërkim shkencor që finalizohet me botime në revista të rankuara. Gjithashtu pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare është një instrument tjetër, i tërthortë, për financimin e kërkimit shkencor dhe aftësimin profesional të stafit në metodat e fundit kërkimore. Për më tepër, siç jemi shprehur edhe më sipër, pjesëmarrja e studentëve në kërkim është e lavdërueshme dhe një pikë e fortë e programit. Në tërësi, GVJ vëren se kërkimi shkencor është një pikë e fortë e programit të studimit.</p> <p><i>Annex No. 4- Curricula of the study program</i></p> <p><i>Annex No. 5- Course Syllabi</i></p> <p><i>Annex No. 93- Summary Tables</i></p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	<p>Nga vizita në institucion, GVJ vuri re se njësia bazë kishte interes dhe përjasje proaktive për të bashkëpunuar me aktorët e tregut të punës sidomos përsa i përket punësimit të të diplomuarve të programit të studimit. Gjithsesi, duke patur parasysh edhe karakterin e programit të studimit si dhe nevojat e tregut të punës në Shqipëri, nuk ka patur kërkesa specifike për studime specifike. Gjithsesi, nëpërmjet projekteve me financim kryesisht nga BE, njësia bazë ka qenë aktive në projekte studimore me karakter kryesisht teorik/akademik.</p>

<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësi përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>GVJ vëren se, Universiteti Epoka ka zhvilluar aktivitete si: konferenca, leksione të hapura, seminare, forume dhe tryeza debati me të ftuar vendas apo të huaj ku kanë marrë pjesë stafi akademik dhe studentët të këtij programi studimi.</p> <p>Gjithashtu, ka patur lektorë të huaj nga universitete partnere, nga institucione ndërkombëtare si dhe lektorë dhe shkëmbime shkencore në kuadër të Jean Monnet dhe Erasmus+. Këto aktivitete forcojnë kontaktet dhe rrisin mundësinë e bashkëpunimit në projekte dhe aktivitete vendore dhe ndërkombëtare.</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Studentët që janë diplomuar në këtë program studimi janë kryesisht të punësuar. Nga analiza që GVJ zhvilloi mbi një pjesë të syllabuseve të programit studimit vuri re fokusin mbi analizën e arritjeve të studentit gjatë gjithë semestrit. Në përfundim të lëndës/modulit, stafi akademik bën vlerësimin e nivelit të aftësive dhe kompetencave të fituara të studentëve në përfundim të çdo semestri dhe evidenton rezultatet e arritura nga studentët siç është analiza e statistikave të sezonit të provimit. Gjithashtu, njësi bazë organizon në fund të vitit akademik rishikimin të programit të studimit në bazë të ecurisë së studentëve në çdo lëndë/modul për nivelin e kompetencave dhe aftësive që ata kanë fituar. Ky proces i strukturuar rrit mundësitë që studentët e diplomuar të kenë aftësi konkurrues në tregun e punës.</p> <p><i>Annex No. 4- Curricula of the study program</i></p> <p><i>Annex No. 5- Course Syllabi</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësi përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me</p>	<p>N/A</p>

aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).							
Konkluzione	<i>GVJ vëren se programi i studimit ofron mundësi për kërkim shkencor dhe në këtë kuadër bashkëpunim me tregun e punës.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI E KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe	Si pjesë e Departmentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, (DSHPMN) programi përpiqet të harmonizojë metodat bashkohore të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të njohurive. Leksionet harmonizohen me një diskutim aktiv, punë në projekte individuale por edhe në grupe si edhe zhvillimin dhe nxitjen e mendimit kritik për të nxjerrë në pah përmbushjen e objektivave mësimore nga ana e studentëve. Kjo arrihet duke zhvilluar analiza mbi papers, ese apo artikuj të marra nga literatura shkencore. Për të siguruar një rezultat

<p>çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>sa më të lartë në mësimnxënie pedagogët ofrojnë një larmi mënyrash sic janë projektet në grupe, prezantimet individuale apo video prezantuese. Këto forma janë mbështetur edhe me infrastrukturën përkatëse në nivel insitucional pasi tek universiteti EPOKA funksionon platforma online e krijuar gjatë pandemisë (ESI), ndërsa vazhdon ta shfrytëzojë infrastrukturën e krijuar për të diversifikuar format e mësimdhënies dhe mësimnxënies, por edhe për administrimin e të dhënave të programit online.</p> <p>Megjithatë, mospasja e një praktike mësimore në këtë program njihet si nga stafi edhe nga studentët si një pikë e cila duhet adresuar. Për këtë qëllim duke filluar nga ky vit akademik, programi përfshin edhe praktikën e studentëve si një element të detyruar të programit.</p> <p><i>Annex Nr. 4- Curricula of the Study Programme</i></p> <p><i>Annex Nr. 2- Regulation on Second Cycle Study Programme Neni 26</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Strategjia e Universitetit 2018-2022 parashikon si prioritet ofrimin e një mjedisi cilësor për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Si një nga tre shtyllat kryesore të strategjisë institucionale, përparësi i jepet evidentimit të metodave dhe metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe ofrimit të metodologjive sa më inovative sic është Hyflex në këtë drejtim. Studentët marrin pjesë në aktivitete kërkimore dhe shkencore të organizara nga stafi akademik, por edhe kanë mundësi e pjesmarrjes në leksionet e hapura me pedagogë të ftuar nga institucione vendase dhe të huaja</p> <p><i>Annex Nr. 12- Epoka University Strategy 2018-2022</i></p> <p><i>Annex Nr. 68- List of Scientific Activities</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e koMShetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Epoka organizon trainime të rregullta vjetore për stafin akademik dhe bashkë me departamentin përkatës mbështesin përhapjen e metodave të suksesshme mësimore ndërmjet stafit akademik, duke synuar rritjen e vazhdueshme profesionale te pedagogëve dhe ofrimin e stimujve për përmirësimin profesional. Për këtë qëllim organizohen: a) aktivitete shkencore si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, ku pedagogët nxiten që të paraqesin punimet e tyre shkencore; b) nxitet botimi i monografive apo artikujve</p>

	<p>shkencore; c) programeve të bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare dhe vecanerisht ne Erasmus Mundus. Por ka edhe trainime specifike sic është “Trainimi për Edukimin Dixhital”.</p> <p><i>Annex No. 59- DoS Annual Activity Report 2021-2022</i></p> <p><i>Annex No. 18- List of Training Activities</i></p> <p><i>Annex No. 19- List of participant staff in academic activities</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është koMShetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Diplomimi i pedagogëve të departamentit ku bën pjesë programi në universitet jashtë vendit, por edhe e eksperiencës ndërkombëtare në mësimdhënie që ka një pjesë e tyre, natyrisht që ndihmon jo vetëm i cilësinë profesionale të tyre, por edhe lejon programin që të përfitojë nga metodat bashkëkohore të mësimdhënies që ata sjellin.</p> <p>Network që këta pedagogë sjellin nga këto eksperiencia ndërkombëtare favorizon bashkëpunimin e mëtejshëm si në kuadër të programeve specifike si p.sh. Erasmus, por edhe në vendosjen e marrëdhënieve bilaterale të bashkëpunimit me institucione akademike evropiane sic janë Universiteti i Studimeve Ndërkombëtare i Romës. Procesi i krijimit të kompetencës në mësimdhënie fillon me kërkesat e lart profesionale në procesin e rekrutimit. Më tej vlerësimi i pedagogut bëhet edhe nëpërmjet një leksioni të hapur. Ndarja e lëndëve bëhet duke patur parasysh ekspertizën dhe specializimin e pedagogut.</p> <p>Pedagogët përpiqen që të ndërtojnë marrëdhënie bashkëpunimi me studentët duke i njohur nivelin e pjekurisë akademike si studentë masteri duke organizuar aktivitete shkencore me ta si edhe bashkëpunimin me këshilltarët e klasave që sjellin zërin e studentëve</p> <p><i>Annex Nr. 6- Academic Staff CV</i></p> <p><i>Annex Nr. 24- List of Students and Academic Staff Mobilities</i></p> <p><i>Annex Nr. 15- Rregullorja e Rekrutimit te Stafit</i></p> <p><i>Annex Nr. 99- Formulari i Vlerësimit të Leksionit të Hapur</i></p> <p><i>Annex Nr. 93- Tabelat Përmbledhëse</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të</p>	<p>DSHPMN përdor mënyra periodike vlerësimi për përmirësimin dhe inovacionin e mësimdhënies nga instancat e</p>

<p>studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>ndryshme të cilat mund të pëmrblidhen në: a) Koordinatori i Departamentit, përgjegjës për organizmin e punës didaktike dhe zhillimin strategjik të departamentit. Ky proces kryhet nëpërmjet analizave periodike të personelit akademik, anketat e vlerësimit të lëndës, kontrolli i cilësisë së syllabuseve, harmonizimin e ngarkesës së stafit akademik; ndihmën që i ofrohet stafit të ri, trainimit per përgatitjen e kurrikulave akademik, vlerësimi i performancë së stafit akademik, etj; b) Vlerësimi nga studentët është një tjetër formë e cila synon dhënien e sugjerimeve për përmirësimin e cilësisë. Për këtë qëllim ekziston një pyetësor i vecantë me 14 pyetje, i cili plotësohet duke analizuar përshtypjet nga pjesmarrja në leksionet e pedagogut që vlerësohet. Kjo praktikë është vecanërisht ndihmuese për pedagogët e rinj. Në këtë mënyrë, ky vlerësim jo vetëm që vë në dukje aspekte që kane nevojë për përmirësim por ofron edhe sugjerime konkrete se si mund të përmirësohen më tej këto dobësi.</p> <p>Raportet e vlerësimit të përgatitura nga kolegët por edhe raporti i transparencës së notave janë pjesë e raportit vjetor vihen në dispozicion pedagogëve përkatës dhe shërbejnë për të hartuar politikat përkatëse për përmirësimin e punës.</p> <p><i>Annex Nr. 31- Course Instructor Evaluation Survey</i></p> <p><i>Annex Nr. 7- Basic Regulations of Epoka; Annex Nr.100, Curriculum Change Procedures)</i></p> <p><i>Annex Nr. 31- Course Instructor Evaluation Survey</i></p> <p><i>Annex Nr. 29- Academic Performance Measurement and Assessment Form</i></p> <p><i>Annex Nr. 16- Staff Guide</i></p> <p><i>Annex Nr. 27- Policy on Continous Improvement of Study Program</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë</p>	<p>IAL ka dy struktura bazë për kontrollin dhe vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies: Komisionin e Sigurimit të Cilësisë dhe Njësinë e Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Zyra e Sigurimit të Cilësisë është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë dhe përmirësimin e këtij niveli duke përdorur një sërë mekanizmesh: 1) Vlerësimet periodike të studentëve për lëndën; 2) Raporti i Komisionit të Zhvillimit të Programeve Mësimore; 3) Raporti i Bordit të Provimeve; 4) Raporti i</p>

<p>aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Bordit të Vlerësimit të Performancës Akademike dhe Përmirësimit të Cilësisë.</p> <p>Vlerësimet e studentëve kryhen në bazë të një lënde të një kursi dhe administrohen çdo semester. Duke ofruar sugjerime si nëpërmjet pyetësorëve por edhe shkëmbimeve të drejtëpërdrejta me pedagogët studentët ndihmojnë jo vetëm në vlerësimin e cilësisë së punës së pedagogut, por edhe përfshihen në përmirësimin e programit të studimit. Vlerësimet dhe raportet e lartpërmendura të pedagogëve i dërgohen drejtuesit të departamentit, i cili ia dërgon Dekanin dhe më pas Rektoratit.</p> <p>Epoka ofron aktivitete vjetore trainimi për pedagogët sidomos për pedagogët e rinj duke u bazuar mbi nevojat që ata paraqesin, në planin/objektivat e punës në procesin e mësimdhënies, dhe propozimet e ardhura nga studentët. Universiteti Epoka është pjesë e projektit “Shkëmbimit Virtual të Universiteteve Shqiptare dhe Evropiane Value X”, i cili synon të ofrojë stafit akademik metodat dhe praktikatat bashkëkohore të mësimdhënies.</p> <p><i>Annex Nr. 33- Quality Policy</i></p> <p><i>Annex Nr. 43- Quality Assurance Handbook</i></p> <p><i>Annex Nr. 31- Course Instructors Surveyw</i></p> <p><i>Annex Nr. 44- Regulation On The Organization and Functioning of the PCQA</i></p> <p><i>Annex Nr.18- Lista e Aktiviteteve Trainuese të organizuara në nivel institucional</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni harmonizon një seri formash të mësimdhënies dhe mësimxënies, falë ekperiencës së pedagogëve dhe punës që bëhet për trainimin dhe zbatimin e praktikave të përparuara për përmirësimin e punës së pedagogëve. Këta të fundit përballen me disa forma vlerësimi, si nga studentët edhe nga strukturat e sigurimit të cilësisë për të matur progresin e arritur në integrimin e formave sa më të përshtatshme të mësimdhënies dhe mësimxënies. Një afirmim mbetet futja e praktikës mësimore në program duke filluar nga ky vit akademik.</i></p>
<p>Shkalla e përbushjes së</p>	<p>Përbushet Përbushet</p>

standardit		Kryesisht	plotësisht
			X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në nenet 26, 27, 28 dhe 37, 38 të Rregullores për Programin e studimit të Ciklit të Dytë përcaktojnë kriteret dhe mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentëve. Mënyra e vlerësimit të studentëve pasqyrohet brenda planit të lëndëve dhe në syllabuset e çdo lënde, ku në një seksion të vecantë paraqiten kriteret e vlerësimit për lëndën. Institucioni ka një formë të miratuar me karakteristikat kryesore të vlerësimit për programet bachelor dhe master por pedagogu i lëndës ka të drejtën e përshtatjes së tyre për një vlerësim sa më të efikas të lëndës.</p> <p>Pas përfundimit të procesit të regjistrimit Zyra e Regjistrimit i pajis studentët me “Udhëzuesin Inteligent të Studentit”, i cili i informon studentët për të gjitha proceset, politikat dhe mekanizmat që drejtojnë aktivitetin e tyre akademik. Në përgjithësi lëndët vlerësohen duke patur parasysh shpërndarjen e aktiviteteve të ndryshme akademike sic janë, provimet e mes-lëndës, quiz, studime në terren, projekte kërkimore të cilat i bashkangjiten provimit apo projektit përfundimtar të lëndës. Në javën e fundit të mësimdhënies, pedagogu bën një përmbledhje të lëndës dhe i informon studentët në lidhje me karakteristikat e provimit.</p> <p><i>Annex Nr.18- List of Training Activities</i></p> <p><i>Annex Nr. 5- Course Syllabi</i></p> <p><i>Annex Nr. 78- Smart Student Guide</i></p> <p><i>Annex Nr.2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'.</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me</p>	<p>Studentët e programit njihen me syllabusin dhe të gjithë elementët e tjerë të kursit, gjatë orës së parë të zhvillimit të lëndës apo modulit. Këtu përfshihen edhe informacionet</p>

metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	lidhur me mënyrën e testimit si edhe kriteret e transparencës për një vlerësim sa me objektiv, të cilat mund të testohen edhe online. <i>Annex Nr. 5- Course Syllabi</i>								
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe koMShetencat e fituara.	Në përgatitjen e formave të testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentit harmonizohen karakteristikat e lëndës dhe zgjedhja që pedagogu konsideron si më të përshtatshmen për këtë qëllim, të cilat janë të përcaktuara në Planin e Lëndës. Në këtë program mënyrat më të frekuentuara të kontrollit të mësim-nxënies janë një harmonizimin i punimeve individuale, provimi i gjysmës së parë të semestrit, prezantimet, projektet individuale ose në grup, quizet, punimet laboratorikedhe provimi përfundimtar. Studentët kanë mundësi të njihen në detaje me kërkesat e formave të vlerësimit të përdorura dhe të bejnë pyetje sqaruese në rast se është e nevojshme. <i>Annex Nr. 5- Course Syllabi</i> <i>Annex Nr. 93- Summary Tables</i>								
Konkluzione	<i>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive duke gërshetuar punën kërkimore gjatë kursit me provën përfundimtare. Zbatimi i këtyre procedurave të testimit të dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore garantohe si nga stafi akademik ashtu edhe ai ndihmës, sic është stafi i IT.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						



Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve	Rregullorja e departamentit përcakton parimet e kriterëve të vlerësimit për kursin, si edhe tabelën e vlerësimit të notave

<p>dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>brenda dy kornizave kohore të dedikuara i.e. provimet afatmesme (java e 8) dhe provimet përfundimtare (java 15-16) e semestrit. Pamvarësisht specifikave të lëndës apo fokusit të pedagogut në vlerësimin e komponentëve të caktuar, tesimi i njohurive bëhet gjatë të gjithë kursit duke u bazuar mbi elementë të ndyshëm sic jane pjesmarrja aktive, përgatitja e projekteve apo prezantimeve. Kjo shihet edhe në shpërndarjen e vlerësimit përfundimtar në disa zëra, çfarë përcaktohet qartë në rregullore duke u harmonizuar me kërkesat e lëndës, dhe konkretisht: a) provimet afatmesme; b) provimi përfundimtar apo detyra kursi (që mund të jetë edhe një prezantim); c) pjesmarrje aktive gjatë periudhës së zhvillimit të lëndës</p> <p><i>Annex Nr. 4, Curricula of the Study Programme</i></p> <p><i>Annex Nr. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Provimet zhvillohen si në formatin e printuar ashtu edhe në atë elektronik, pasi institucioni ka vënë në dispozicion të pedagogëve sisteme elektronike të vlerësimit të cilat sigurojnë aksesin e studentëve në informacionin e nevojshëm sic janë notat, frekuentimi etj, por edhe sigurojnë transparencën e vlerësimit dhe shmangin format e mundshme të abuzimit.</p> <p>Të gjitha papers, ese apo të tjera punime të studentëve kalojnë nëpërmjet sistemi Turnitin dhe niveli i plagjaturës nuk duhet të kalojë 20%, ndërsa provimet zhvillohen në mënyrë anonime dhe studentët shkruajnë vetëm numrin e tyre të ID. Klasat e provimit mbikqyren nga një sistem kamerash sigurie dhe shoqërohen nga prania e një personeli mbikqyrës.</p> <p><i>Annex Nr. 89- EIS Student Guideline</i></p> <p><i>Annex Nr. 35- Exam Anonymity Process.</i></p> <p><i>Annex Nr.32- Guideline On Examinations</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Vlerësimi përfundimtar bëhet duke zbatuar rregulloret dhe kërkesat e syllabusve përkatës për cdo lëndë, dhe rregulloren e insitucionit dhe zhvillohet duke marrë parasysh vlerësimet e pjesshme dhe ato përfundimtare të secilit element të testimit të lëndës sic u përmend më sipër. Për një transparencë sa më të plotë, përqindjet e vlerësimit për cdo element vendosen në</p>

	<p>një rubrikë të vecantë të syllabus, si edhe u shpjegohet studenteve në fillim të cdo lënde Bordi i Provimeve kontrollon cilësinë e provimeve të zhvilluara gjatë cdo viti akademik dhe nëpërmjet një raporti përgatit sugjerime dhe rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të punës.</p> <p><i>Annex Nr. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'..pdf</i></p> <p><i>Annex Nr. 32- Guideline On Examinations</i></p> <p><i>Annex Nr. 36- Directive On the Functioning of the Exam Board</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Pedagogët ofrojnë sugjerime dhe feedback për secilin nga elementët e vlerësimit të studentit. Vlerësimit të studentit i bashkangjitet një feedback nga ana e pedagogut dhe përcillet përmes email apo komunikimit direkt të secilit student me pedagogun për të sqaruar arsyet e vlerësimit, ndërsa studentët inkurajohen që të shprehin ankesat e tyre për vlerësimin. Një ekspert i caktuar nga Dekanati për dy semestra kryen vlerësimin e provimit si përsa i takon përpunueshmërisë së provimit me kërkesat e lëndës ashtu edhe përsa i takon feedback që pedagogu ka ofruar për studentët në elementët e ndryshëm të testimit.</p> <p><i>Annex Nr. 32- Guideline On Examinations</i></p> <p><i>Annex Nr. 36- Directive On the Functioning of the Exam Board</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Universiteti përcakton në “Rregulloren për Disiplinën e Studentëve” dispozitat për shkeljet disiplinore, sic mund të jetë kopja apo format e tjera të mashtrimit, rastet e të cilave trajtohen përmes një komisioni të pavarur disiplinor. Sikundër u përmend më lart, ekziston sistemi Turnitin kundër plagjaturës, të cilit i nënshtrohen të gjithë punimet e studentëve. Plagjatura sqarohet gjerësisht nga pedagogët për studentët si gjatë kursit, në mënyrë që studentët të informohen se si duhet çfarë përbën plagjaturë dhe si mund të bëhen citimet e materialeve shkencore.</p> <p>Sikundër u theksua më lart “Udhezuesi për Provimet” përcakton si pedagogët marrin masa që proceura e provimit të jetë e pakorruptueshme dhe zbatojnë rregulloren e universitetit për të gjithë ata studentë që shkëlin etikën</p>

	<p>akademike. Së bashku me specialistin IT krijohet dritarja përkatëse ku studentët mund të dorëzojnë detyrat e përfunduara.</p> <p><i>Annex Nr. 33- Regulation on student discipline.</i></p> <p><i>Annex Nr. 88- Guidelines for the use of information technology infrastructure</i></p> <p><i>Annex Nr. 32- Guideline On Examinations</i></p> <p><i>Annex Nr. 76- Information on Infrastructure capacities in the function of study program</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Sic u përmend edhe më lart provimet kryhen në anonimitet të plotë dhe ID krijohet në mënyrë të rastësishme nga zyra e IT për çdo student gjatë semestrit. Ekzistojnë forma të ndryshme të kontrollit të dijeve dhe aftësive personale të studentëve duke patur parasysh objektivat didaktike të lëndës. Këto forma përfshijnë aftësitë analitike të studentëve, ato prezantuese, kapacitetet për të sintetizuar materialin që i vihet në dispozicion dhe promovuar një këndvështrim kritik. Në këtë mënyrë dhe me anë të një testimi të vazhdueshëm të njohurive, vlerësimi me notë i studentit pasqyron kompetencën e studentit në zotërimin e lëndës.</p> <p>Rregullorja përcakton afatet e dorëzimit të notave në sekretarinë mësimore jo më shumë se 1 javë nga data e provimit përfundimtar pasi më parë sekretaria ka informuar pedagogët lidhur me këto data, që në fillim të vitit akademik. Ky informacion është i pasqyruar në kalendarin akademik, i cili publikohet edhe në faqen e internetit të universitetit. Pedagogu ia dorëçon dosjen e provimit koordinatorit të departamentit 10 ditë pas periudhës së provimit përfundimtar dhe në përmbajtje të saj janë të gjitha fletët e provimit; përgjigjet e sakta, një kopje e provimit përfundimtar dhe dy kopje të notave të përfunduara.</p> <p><i>Annex Nr. 32- Guideline On Examinations</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që</p>	<p>Studentët njihen me notën përpara se kjo të dorëzohet në sekretari dhe mund të shprehin mendimin e tyre lidhur me vlerësimin si edhe të kërkojnë të takohen me pedagogun për të marrë një arsyetim lidhur me vlerësimin me notë. Studentët kanë të drejtën e ankimit për notën brenda 5 ditëve nga marrja e përgjigjes së provimit pranë pedagogut të lëndës, i cili</p>

<p>përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>shqyrton nëse ka patur ndonjë gabim në korrigjimin e provimit, dhe në rast se studenti nuk bindet për argumetimin ka të drejtë të ankohet pranë dekanatit që ngre një komision të posacem vlerësimi.</p> <p>Studentët ndjekin një procedurë te vecantë për ankimimet në të gjitha nivelet dhe për të gjitha strukturat duke përfshirë si anën akademike ashtu edhe atë logjistike apo administrative</p> <p><i>Annex Nr. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i></p> <p><i>Annex Nr. 40- Grade Appeal Form</i></p> <p><i>Annex Nr.41- Procedures for Students Complains for Academic and Other Issues</i></p>		
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studentët kanë të drejtë të ankimojnë notën fillimisht me pedagogun e lëndës dhe nëse pedagogu nuk e gjykon me vend të rishikojë notën, atëherë studenti i drejtohet koordinatorit të Departamentit, për të përfunduar më pas me komisionin vlerësues që ngrihet nga dekanati; procedurat për këtë ankimim janë të sanksionuara në Udhëzuesin Inteligjent të Studentit.</p> <p>Procedurat janë transparente dhe mund të ndiqen në cdo hap si nga studenti ashtu edhe nga Zyra e Regjistrimit, e cila dokumenton dhe arkivon cdo hap duke përfshirë edhe raportin përfundimtar të aprovuar nga dekanati</p> <p><i>Annex Nr. 78, Smart Student Guide</i></p> <p><i>Annex Nr. 36- Directive On the Functioning of the Exam Board</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Procedurat e vlerësimit janë të drejta dhe bëhen transparente që në fillim të vitit akademik si nepermjet syllabuseve ashtu edhe sqarimit që bëhet përpara cdo testimi nga ana e pedagogut. Vlerësimi bazohet në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit, i cili sigurohet nga legjislacioni i institucionit. Këto informacioni u vërtetuan edhe nga bisedat me studentët edhe stafit akademik.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të koMShetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret**Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.

Programi i studimit i ofron studentëve njohuri si të zhvillojnë aftësitë kritike në disipinat e ndryshme brenda programit të studimit Profili akademik i pedagogëve, bashkëpunimi i tyre në nivel akademik me homologët në aktivitete shkencore ku marrin pjesë edhe studentët krijojnë mundësi që këto njohuri të mund të pasqyrohen edhe në lëndët përkatëse dhe në programin didaktik që vihet në dispozicion të studentëve. Azhurnimi i vazhdueshëm i lëndëve me literaturën bashkëkohore por edhe thellimi i kërkimit shkecor individual nga ana e pedagogëve kontribuojnë në këtë drejtim

Megjithatë një diferencim më i mirë i lëndëve ndërmjet masterit profesional dhe atij shkencor përvetë diferencimi në projektet që u ngarkohen studentëve, si edhe ndryshimi ndërmjet tezës në provimin përfundimtar për masterin profesional dhe tezës për masterin shkencor duhet të thellohen më tej si në larinë e tematikave të ofruara ashtu edhe në ndryshimin e mësimdhënies për secilën temë.

Annex Nr.68- List of Scientific Activities

Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).

Programi i studimit parashikon një harmonizim të njohurive specifike të fushës me ato të teknologjisë së informacionit apo edhe komunikimit duke përfshirë këtu edhe gjuhën e huaj. Transmetimi i njohurive tek studentët kryhet duke përfshirë si njohuri metodologjike ashtu edhe punën konkrete nëpërmjet projekteve individuale ose në grup – për të mbështetur zhvillimin e soft-skills - apo detyrave të kursit për të nxitur zhvillimin e mendimit kritik të studentëve. Për të arritur një nivel të lartë kërkimi ashtu edhe për prezantimin e punës së kryer, studentët mbështeten tek teknologjia e informacionit (e-library apo format e ndryshme të prezantimit).

Annex Nr.5- Course Syllabi

Kriteri 3. KoMShetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe

Stafi akademik prezanton për studentët Planin e Lëndëve, i cili shpjegon objektivat mësimore, dhe shpjegon të gjitha njohuritë dhe aftësitë që zhvillon studenti gjatë vitit akademik së bashku me aftësitë ndërvepruese të përmendura më lart si

<p>syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>per shembull soft-skills apo në teknologjitë e informacionit, analizohen nga pedagogu në përfundimin e lëndës apo te semestrit. Ne takimin me studentet, GVJ vërejt se kjo analizë e njohurive që duhet të përfitohen por edhe asaj që mbetet ende për tu bërë ndihmon studentët për ti adresuar këto objektiva por edhe sugjerimet e pedagogëve në vijim të studimit akademik. Kjo praktikë u konfirmua edhe në takimin me pedagogët të cilët theksuan se kanë takime të vazhdueshme me studentët dhe në këto konsultime ofrohen sugjerimet përkatëse për përmirësimin e punës me studentët.</p> <p><i>Annex Nr.5- Course Syllabi</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë koMShetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Mësimdhënia zhvillohet duke u bazuar në kompetencat që synon të arrijë programi duke u bazuar në dy metodologji kryesore: teorike dhe praktike. Në aspektin teorik studentët përfitojnë nga leksionet, materiali shtesë, literatura e rekomanduar, si edhe informacioni e aksesueshme. Kjo realizohet falë infrastrukturës në aspektin teorik sic është libraria online, biblioteka apo edhe aksesit që kanë studentët në programe të ndryshme të literaturës.</p> <p>Ndërkohë institucioni vë në dispozicion të studentëve të programit infrastrukturën e nevojshme për të realizuar në aspektin praktik aktivitete të ndryshme sic janë hulumtimet, diskutimet në grupe ku studentët paraqesin pikpamjet e tyre lidhur me temën që trajtohet dhe interpretimin e tyre mbi njohuritë e marra. Pedagogu sigurohet që diskutimi të jetë gjithëpërfshirës dhe sa më shumë studentë të marrin pjesë.</p> <p>Mobiliteti i pedagogëve dhe studentëve si në ardhje ashtu edhe në dalje me insitucione si Universiteti i Studimeve Ndërkombëtare të Romës, Universiteti Fulda etj, (nxitet nga njohuritë e studentëve dhe stafit në gjuhën angleze.</p> <p><i>Afirmimi se praktikat mësimore në këtë program do të fillojnë në këtë vit akademik, 2023 është ajo cka kërkohet si nga pedagogët ashtu edhe nga studentët.</i></p> <p><i>Annex Nr.93-Summary Tables</i></p> <p><i>Annex Nr. 26, List of Foreign Partnership Agreements</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të</p>	<p>Personeli akademik është i organizuar në vazhdimësi në veprimtari shkencore jashtë programit të studimit dhe për këtë qëllim organizon orë të hapura me guest-lectures por edhe</p>

hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	inkurajon studentët që të marrin pjesë në seminarët akademike të organizuara nga Epoka apo institucione të tjera duke paraqitur edhe punimet e përgatitura nga studentët në bashkëpunim edhe me pedagogët <i>Annex Nr. 67- List of University Sponsored Participants in Scientific Activities</i>						
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Pedagogët promovojnë pjesëmarrjen e studentëve në aktivitetet shkencore ku ata mund të marrin pjesë me prezantime për të inkurajuar më tej idetë e tyre inovative duke i ofruar edhe mundësinë e financimit të pjesëmarrjes në këto aktivitete. Gjithashtu universiteti nxit nëpërmjet financimit edhe hapjen e klubeve sic është “Klubi i Zgjidhjes së Konfliktëve”apo aktiviteteve të tjera studentore që lidhen me fushat e studimit apo aktivitete shoqërore. <i>Annex Nr.93-Summary Tables</i> <i>Annex Nr.57, Directive on Students Club</i>						
Konkluzione	<i>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët nëpërmjet harmonizimit të metodave të mësimdhënies dhe mësimnxënies me kërkimin shkencor, studimet në terren, por edhe falë mobilitetit të pedagogëve të huaj apo edhe studentëve. Pjesëmarrja e studentëve si në aktivitetet akademike ashtu edhe në ato kërkimore synon zhvillimin e thelluar të kompetencave të tyre profesionale dhe shkencore. Megjithatë afirmimi i praktikave mësimore duke filluar në vitin akademik 2023, si edhe një diferencim më i plotë i programit master shkencor dhe atij profesional janë objektiva të qarta për zhvillimin e mëtejshëm të programit.</i>						
Sëkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbyllet</th> <th>Përmbyllet kryesisht</th> <th>Përmbyllet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbyllet	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht			X
Përmbyllet	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht					
		X					

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmblyëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton	Rregullorja e Universitetit (<i>nenet 33, 35, 36, 42</i>) përcakton

<p>procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>procedurat që duhet të ndjekin studentët lidhur me detyrimet përmbyllëse dhe projektin e diplomimit. Përsa i takon programit të masterit shkencor, studentët duhet që fillimisht të përmbyllin të gjitha detyrimet për cdo modul të programit dhe më pas mund të fillojnë punimin përfundimtar për diplomimin, informacioni i cili është i aksesueshëm online dhe bëhet në konsultim me pedagogun. Punimi përfundimtar konsiston në një thesis të cilën studentët fillojnë ta hartojnë në semestrin përmbyllës të vitit të dytë të programit, ndërsa e gjithë procedura përshkruhet në dokumentin përkatës “PIR 500-Thesis”.</p> <p><i>Annex Nr.2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i> <i>Annex Nr. 32- Guideline On Examinations</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Cdo pedagog i caktuar si mbikqyrës i tezës punon me studentit duke e udhëzuar për forminin e argumentit shkencor dhe materialet e që duhet të konsultojë studentin. Pedagogët por edhe sekretaria mësimore i ndihmojnë studentët me informacionin e nevojshëm lidhur me detyrimet afatet kohore dhe procedurat e realizimit të detyrimeve përmbyllëse. Ky informacion përfshin si detyrimet akademike ashtu edhe ato financiare që studentët kanë për përmbylljen e programit.</p> <p><i>Annex Nr.78- Smart Student Guide</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Programi nuk organizon një provim përfundimtar për të testuar njohuritë e studentëve në përfundim të programit por një punim përfundimtar të diplomës. Departamenti ngre një komision të posaçëm me anëtarët e departamentit për administrimin e punimeve të thesis (dizertacionit). Ky komision vlerëson dhe ofron feedback për cdo punim, përpara se të shpallet nga departamenti data e mbrojtjes me gojë të dizertacioneve.</p> <p><i>Annex Nr. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës.</p>	<p>Studentët mund të zgjedhin ndërmjet stafit akademik të programit udhëheqësin për dizertacionin duke patur parasysh përputhshmërinë e fushës së kompetencave akademike të pedagogut me temën e dizertacionit që ata mendojnë. Më pas së bashku me udhëheqësin kristalizohet më tej tema e dizertacionit. Përcaktimi i udhëheqësit dhe temës së</p>

<p>Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>dizertacionit i hap rrugën aprovimit nga ana e koordinatorit të Departamentit.</p> <p>Studenti punon në temën e dizertacionit duke u konsultuar dhe orientuar në çdo hap nga udhëheqësi duke filluar nga gërshetimi i metodologjisë së dizertacionit me kerkimin shkencor, rezultatet, përpunimin e tyre dhe hartimin e konkluzioneve. Studenti paraqet drafte të punës dhe merr vazhdimisht feedback nga udhëheqësi, i cili duhet të japë aprovimin në mënyrë që studentit të mund të dorëzojë tezën.</p> <p><i>Annex Nr. 4, Curricula of the Study Programme</i></p> <p><i>Annex Nr. 105, Master Thesis Examination Report</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Udhëheqësit i asistojnë studentët në të gjitha hapat e përgatitjes dhe punimit të dizertacionit. Përveç vendosjes në dispozicion të studentit të të gjithë bazës së nevojshme materiale brenda institucionit për hartimin e dizertacionit, udhëheqësi ofron gjithashtu nëpërmjet kontakteve personale edhe mundësinë që studentit të marrë ekspertizën dhe ndihmen e nevojshme me ekspertë jashtë institucionit kur kjo është e nevojshme</p> <p><i>Annex Nr. 105, Master Thesis Examination Report</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Dizertacioni vlerësohet nga komisioni prej tre anëtarësh i ngritur dhe aprovuar për këtë qëllim nga Dekanati duke patur parasysh cilësinë shkencore të punimit, si edhe duke i ofruar studentit feedback lidhur me aspektet pozitive ashtu dhe pikat që meritonin më shumë vemendje. Komisioni jep feedback mbi vlerësimin e bërë me shkrim. Si minimum i notës kaluese konsiderohet pragu i 50%</p> <p><i>Annex Nr. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i></p> <p><i>Annex Nr. 105, Master Thesis Examination Report</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në</p>	<p>IAL në rregulloren e institucionit ofron udhëzime të qarta për pajisjen e studentit me diplomën e Masterit. Në përfundimin e suksesshëm të programit të gjithë studentët pajisen me diplomën e Masterit Shkencor dhe me suplementin e diplomes. Forma dhe përmbajtja e këtyre dokumentave janë të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe Qendra Kombëtare e Shërbimit të Studentëve (QSHA), dhe rregjistrohen pranë Zyrës së Rregjistrimit, ndërsa dorëzimi i tyre bëhet në një</p>

dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	ceremoni të vecantë (neni 38 dhe 39, Rregullore për Programet e Studimit të Ciklit të Dytë). <i>Annex Nr. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i>						
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sekretaria Mësimore ka si detyrë mbajtjen e regjistrit themeltar me të dhënat e studentëve, si në formën fizike ashtu edhe në atë elektronike. Kjo Sekretari ngarkohet edhe me mbajtjen e kartelës së studentit ku pasqyrohen kreditet e akumuluar. Dosjet personale të studentëve pas diplomimit ruhen në arkivin qendror të universitetit duke respektuar normat në fuqi për privatësinë por edhe rregulloren e këtij arkivi <i>Annex Nr. 52, Procedure of Students Records</i> <i>(Annex Nr. 79, Institutional Policies for Disclosure of Information).</i>						
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë dhe transparente të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit. Ky hap ndërmerret vetëm pasi studenti ka shlyer të gjitha detyrimet akademike, ndërsa ndihmohet në të gjithë procesin nga udhëheqësi i tezës finale. Epoka e përgatit studentin me dokumentacionin e nevojshëm duke përfshirë si diplomën ashtu edhe diploma suplement.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X
Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht					
		X					

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë	Ky kriter nuk aplikohet

institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.							
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe koMShetencave profesionale.	Ky kriter nuk aplikohet						
Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Ky kriter nuk aplikohet						
Konkluzione	<i>GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Nga analiza e RVB, DVV si dhe nga takimet në vizitën në institucion, GVJ konstaton se fakulteti dhe njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, ka një angazhim mëse të përshtatshëm burimesh njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Nga analiza e dokumentacionit dhe tabelave shoqëruese të RVB, GVJ konstaton se përmbushen kërkesat ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit.</p> <p>Nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, (<i>Annex No. 93- Summary Tables, tab 6.1-6.5.pdf</i>).për realizimin e programit të ciklit të dytë të studimit Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare, janë angazhuar staf akademik për katër vite akademike si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Për vitin akademik 2019- 2020 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 9 pedagogë nga të cilët 8 PAE dhe 1 PAK (88.8 % /11.2 %) 2. Për vitin akademik 2020 - 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 8 pedagogë nga të cilët 7 PAE dhe 1 PAK (87 % /13 %) 3. Për vitin akademik 2021 - 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 7 pedagogë nga të cilët 4 PAE dhe 3 PAK (57 % / 43 %) 4. Për vitin akademik 2022- 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 8 pedagogë nga të cilët 7 PAE dhe 1 PAK (87 % /13 %) 				
	Tituj/ grada	2019-2020	2020-2021	2021-2022	2022-2023

	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	1	-	1	-	-	-	-
Prof. Asoc.	2	-	2	-	1	-	1	-
Dr./PhD.	5	-	5	-	3	2	6	1
Msc.	-	-	-	-	-	1	-	-
Totali	8	1	7	1	4	3	7	1

Annex No. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'

Annex No. 7- The Basic Regulation of EPOKA University

Annex No. 93- Summary Tables

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, kërkuar gjatë vizitës në institucion *Annex No. 93- Summary Tables, tab 12.2-12.5*) mbulimi i ngarkesës mësimore për 4 vite rezulton:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2019-2020	576	528	48	90% / 10 %
2020-2021	576	528	48	90% / 10 %
2021-2022	624	456	168	73% / 27%
2022-2023	576	528	48	90% / 10 %

Nga tabela rezulton që për të 4 vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017.

Annex No. 93- Summary Tables

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e

Nga analiza e tabelave shoqëruese të RVB, por edhe nga takime në institucion me stafin akademik dhe drejtuesit e njësisë bazë dhe asaj kryesore, vihet re një qëndrueshmëri i

<p>personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>qartë dhe e lavdërueshme e stafit akademik përfshirë edhe atë PAK. Nga takimi në zyrën e personelit vumë re që dosjet e personelit akademik ishin të plota dhe që, nga përzgjedhja rastërore, stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi kishte kontrata të rregullta sipas kriterëve ligjore në fuqi.</p> <p><i>Annex No. 93- Summary Tables</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në analizën e GVB, DVV dhe vizitën në institucion, GVJ konstatoi se procedura e rekrutimit është e mirë-rregulluar dhe e njohur për të gjithë aktorët e institucionit. Kjo procedurë fillon me konstatimin e vakancave apo nevojave për staf shtesë nga njësia bazë e cila harton kërkesë për rekrutim stafi akademik drejtuar dekanit dhe rektorit. Në këtë kërkesë, njësitë bazë specifikojnë edhe kriteret specifike për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilat variojnë sipas nevojave të programit të studimit. Kriteret i përcillen zyrës së burimeve njerëzore të cilat pasi përpunohen i përcillen rektorit dhe administratorit i cili i miraton. Shpallja e vakancave publikohet në faqen web të institucionit, në rrjete sociale dhe faqe ndërkombëtare punësimi kur është e nevojshme.</p> <p>Për përzgjedhjen, ngrihet një komision i kryesuar nga dekani i njësisë kryesore të programit të studimit, i cili është përgjegjës për procedurën e rekrutimit me dy faza. Faza e parë lidhet me shqyrtimin paraprak të aplikimeve që janë dorëuar, ndërsa faza e dytë është intervistimi i kandidatëve që plotësojnë kriteret e fazës së parë. Komisioni përgatit një raport vlerësimi i cili i përcillet rektorit dhe punësimi bëhet pasi merret miratimi përkatës.</p> <p><i>Annex No. 1- Statute of EPOKA</i></p> <p><i>Annex No. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i></p> <p><i>Annex No. 15- Regulation on Staff Recruitment</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për</p>	<p>Bazuar në analizën e GVB, DVV dhe vizitën në institucion, GVJ konstatoi se njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, siç u shprehëm edhe më sipër, ka angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të këtij programi. Këto burime njerëzore përmbushin kriteret ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të stafit. Specifikisht, për këtë program studimi,</p>

<p>mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>nuk ka nevojë për personel ndihmës akademik për orë laboratorike.</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe specifikisht në zyrën e burimeve njerëzore dhe sekretarinë mësimore, GVJ u njoh nga afër me mënyrën se si ruhej dokumentacioni për këtë program studimi. GVJ vuri re se informacioni në lidhje me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit ruhej në dy nivele. Të dhënat në lidhje me stafin akademik fillimisht mblidhen dhe depozitohen pranë njësisë përgjegjëse për programin e studimit. Në nivelin e dytë, të dhënat në lidhje me stafin, si akademik ashtu edhe atë drejtues dhe ndihmës mësimor, administrohen nga zyra e burimeve njerëzore, e cila disponon dosjet e plota për çdo personel. Gjatë vizitës në institucion GVJ nuk evidentoi mangësi në dosjet e personelit akademik.</p> <p>Annex No. 1- Statute of EPOKA</p> <p>Annex No. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</p> <p>Annex No. 7- The Basic Regulation of EPOKA University</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e koMShani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti Epoka ka një marrëdhënie të mirë-strukturuar me botën jo akademike dhe kjo reflektohet në marrëveshjet e bashkëpunimit si dhe aktivitetet e përbashkëta që zhvillohen periodikisht. Në tërësi, institucioni ka një sërë marrëveshjesh me aktorë të tregut të punës që mundësojnë praktika të qenësishme (për programet e tjera të studimit) dhe punësim potencial pas diplomimit. Gjithësesi, dhe kjo është një pikë e rëndësishme që e kemi thënë edhe më sipër, faktkeqësisht praktika nuk është ende pjesë zyrtare e kurrikulës. Edhe pse ajo do të përfshihet vitin e ardhshëm akademik, mbetet vonë sidomos duke patur parasysh faktin që është një rekomandim nga akreditimi i kaluar.</p> <p>Annex No. 93- Summary Tables</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave</p>	<p>Duke qenë që praktikat profesionale ende nuk janë pjesë e kurrikulës së programit, nuk ka personel mbikqyrës të dedikuar.</p>


profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.							
Konkluzione	<i>Njësia kryesore dhe ajo bazë përgjegjëse për programin e studimit kanë sasinë e nevojshme të stafit akademik i cili ka formimin e përshtatshëm dhe kualifikimin e kërkuar nga ligji. Mungesa e praktikës profesionale në kurrikul është një mangësi e qenësishme.</i>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe vizitës së ambjenteve mësimore, GVJ konstatoi se kushtet infrastrukturore i mundësonin personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ kryerjen me efektivitet të detyrave të tyre. Mjediset e IAL gjenden në një kampus modern universitar rreth 20 minuta larg Tiranës e janë lehtësisht të aksesueshme (institucioni ofron transport me autobus të dedikuar). Zyrat e pedagogëve dhe stafit administrativ ishin të pajisuar me mobilimin dhe pajisjet teknologjike të nevojshme. Po aq e rëndësishme, ambientet e IAL mbulohehin me wireless që ofronte internet për stafin dhe studentët.</p> <p><i>Annex No. 93- Summary Tables</i></p> <p><i>Annex No. 76- Information on Infrastructure capacities in the function of study program.</i></p>

	<i>Annex No. 77- Recent Report of the MES on the Verification of the Infrastructure and Academic Capacities. (Rorti Verifikimi i Kapaciteve 2022-2023)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ambientet mësimore të IAL ishin të përshtatshme pasi ishin të pajisura me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless dhe tabela inteligjente që krijojnë kushtet për realizimin cilësor të procesit mësimor. Laboratorët e IT kanë poste të pajisura me PC dhe programet përkatëse te nevojshme për zhvillimin e punës kërkimore.</p> <p><i>Annex No. 93- Summary Tables</i></p> <p><i>Annex No. 76- Information on Infrastructure capacities in the function of study program.</i></p> <p><i>Annex No. 77- Recent Report of the MES on the Verification of the Infrastructure and Academic Capacities. (Rorti Verifikimi i Kapaciteve 2022-2023)</i></p>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni ka laboratorë të pajisur me programe profesionale në përputhje me tipologjinë e programeve të studimit që ofron. Shfrytëzimi i laboratoreve nuk ishte i kufizuar vetëm gjatë orarit mësimor, por edhe sipas kërkesave dhe nevojave të studentëve. Specifikisht, ky program studimi nuk ka nevojë për laboratorë specifikë apo të dedikuar.</p>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ambientet mësimore të IAL ishin të përshtatshme pasi ishin të pajisura, ndër të tjera, me videoprojektorë, sisteme audio, lidhje interneti wireless dhe tabela inteligjente që krijojnë kushtet për realizimin cilësor të procesit mësimor. Laboratorët e IT kanë poste të pajisura me PC dhe programet përkatëse te nevojshme për zhvillimin e punës kërkimore.</p>
Kriteri 5. Institucioni	Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e





<p>garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se ambientet në dispozicion të këtij programi studimi janë mëse të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Për më tepër, institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione akademike dhe subjekte biznesi të cilat mundësojnë punësimin potencial të studentëve.</p>
--	---

<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vëren se institucioni disponon mjediset mësimore dhe infrastrukturën mbështetëse në dispozicion të programit të studimit për të mundësuar formimin teorik dhe shkathtësimin praktik të studentëve.</i></p>
---------------------------	--



<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

<p>Standardi IV.3</p>	
<p>Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e</p>	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se literatura në gjuhën angleze dhe shqipe në dispozicion të studentëve është e bollshme dhe e përshtatshme. Duke ju referuar syllabueseve të lëndëve, GVJ konstatoi se lëndët referojnë literaturë të bollshme dhe kryesisht bashkëkohore me</p>

<p>dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>tekste mësimore të autorëve më të njohur dhe ekspertëve ndërkombëtarë më në zë të fushës. Po aq e rëndësishme, institucioni ka regjistrime në biblioteka digjitale me burime akademike bashkëkohore që mundësojnë studentëve akses në materialet më të mira të fushës së shkencave politike dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.</p> <p><i>Annex No. 81- List of all books in Library</i></p> <p><i>Annex No. 82-List of books newly added in Library since last Accreditation</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përfthuara gjatë vizitës në institucion, u informuam se njësia bazë bënte herë pas here kërkesë për tekste dhe burime të tjera të nevojshme. Procesi midis njësisë bazë, asaj kryesore dhe bibliotekës ishte i mirë-rrregulluar dhe të gjitha tekstat e nevojshme (fizikisht ose online) ishin të aksesueshëm nga studentët e programit të studimit.</p> <p><i>Annex No. 81- List of all books in Library</i></p> <p><i>Annex No. 82-List of books newly added in Library since last Accreditation</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas raportimeve të paraqitura në RVB dhe DVV IAL raporton se disponon salla për biblioteka të cilat ishin të përshtatshme për lexim e studim. Biblioteka e institucionit është moderne, me 100 poste fikse për studentët, me hapësira të bollshme dhe e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme. Orari i funksionimit të bibliotekës është 8.30 – 19.30.</p> <p>Siç e thamë edhe më sipër, biblioteka i ofron studentëve burime fizike dhe digjitale dhe informacioni dhe është një pikë e fortë e institucionit në tërësi si dhe e programit të studimit.</p> <p><i>Annex No. 83- Procedure on library and literature enrichment.</i></p> <p><i>Annex No. 85- Information on Library Services.</i></p> <p><i>Annex No. 86- Directive on the Library</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën</p>	<p>Sipas raportimeve të paraqitura në RVB dhe DVV IAL raporton se në bibliotekat e tij gjenden fizikisht gjithsej 25.000 tituj librash 600 prej të cilëve i dedikohen programit të studimit në gjuhën shqipe dhe atë angleze. Ketyre burimeve i shtohen edhe ato digjitale, si për revista ashtu edhe për libra, të</p>

<p>shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>cilat i ofrojnë studentëve – por edhe stafit akademik një gamë të gjerë dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe kërkimor.</p> <p><i>Annex No. 81- List of all books in Library</i></p> <p><i>Annex No. 82-List of books newly added in Library since last Accreditation</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas raportimeve të paraqitura në RVB dhe DVV IAL raporton se ka akses në 16 librari online duke përfshirë edhe Jstor e cila është e rëndësishme për shkencat politike dhe mbulon mbi 2.000 revista akademike. Këto burime mund të përdoren në rrejetin e institucionit si dhe jashtë tij nëpërmjet profilit të studentit që mundësohet nga institucioni. Gjithashtu studentët kanë akses në depon digjitale “Dspace” ku kanë qasje në të gjitha burimet akademike digjitale.</p> <p><i>Annex No. 85- Information on Library Services</i></p> <p><i>Annex No. 86- Directive on the Library</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe komShjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, siç u shprehëm edhe më sipër, GVJ konstatoi se në IAL ofrohet akses në Internet pa kufizim nëpërmjet wireless që i jep mundësi studentëve të kërkojnë në bibliotekën online. Por, dhe po aq e rëndësishme, në bibliotekë kishte 100 poste pune nga të cilat 4 me kompjutera me software të dedikuar. Sipas GVJ hapësira dhe burimet e vëna në dispozicion janë të mjaftueshme e të përshtatshme për programin e studimit.</p> <p><i>Annex No. 85- Information on Library Services</i></p> <p><i>Annex No. 86- Directive on the Library</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe</p>	<p>Sipas RVB dhe DVV, salla e bibliotekës së institucionit konsiderohet njësi ndihmëse në funksion të objektivave të programeve të studimit dhe si të tilla oraret e tyre koordinojnë me oraret e ofrimit të mësimin në programet e studimit. Siç u shprehëm edhe më sipër, biblioteka kishte 4 poste pune me kompjuter dhe 100 poste në total. Ajo ishte gjithashtu e pajisur me printer dhe fotokopje në funksion të kërkesave të studentëve. Oraret e funksionimit të sallave në periudha normale ishin nga ora 8.30 – 19.30. të cilën GVJ e konsideron</p>

kapacitetit të saj.	të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e procesit mësimor.		
	Annex No. 85- Information on Library Services Annex No. 86- Directive on the Library		
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Sipas RVB dhe DVV, IAL angazhohet në nxitjen e njërive kryesore dhe bazë që cdo vit të paraqesin kërkesat për tituj të rinj në funksion të përmbushjes së objektivave të programeve të studimit që ofrojnë. Një pjesë e tujve të rinj të shtuar së fundmi në bibliotekë janë botime të fundit si dhe aksesit në Jstor që janë zhvillimi shumë pozitive.		
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni disponon literaturën e nevojshme dhe mjediset mbështetëse për mësimdhënie dhe mësimnxënie.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni	Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e

<p>disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>përfutuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se IAL përdor një sistem të automatizuar të menaxhimit të informacioneve në lidhje me studentët dhe procesin mësimor në tërësi. EIS – Sistemi Interaktiv Epoka – i cili mundëson koordinimin efektiv mes stafit akademik dhe atij mbështetës nga njëra anë dhe studentëve nga ana tjetër. Sistemi ofrohet në gjuhën shqipe dhe angleze dhe siç referohet në RVB është krijuar nga vetë IAL. Sistemi ka akses të vecantë për stafin akademik dhe për studentët dhe funksionon edhe me akses nga jashtë institucionit. Siç u informuam gjatë vizitës në institucion, ky sistem kishte përdorim të gjerë nga ana e stafit dhe studentëve dhe atyre u ofroheshin trajnime përgatitore për përdorimin e sistemit.</p> <p>EIS përdorej gjerësisht edhe nga stafi administrativ. Të dhënat përditësohen elektronikisht, përveçse mbahen në hard-copy në regjistrat e notave dhe të diplomave në Sekretarinë Mësimore. Ndërsa, të dhënat personale të studentëve hidhen në regjistrin e amzës (regjistri themeltar) dhe të gjitha regjistrat në formë të shkruar dhe version elektronik janë në administrimin e Sekretarisë Mësimore.</p> <p><i>Annex No. 88 - Guidelines for the use of information technology infrastructure.</i></p> <p><i>Annex No. 89- EIS Student Guideline</i></p> <p><i>Annex No. 90- EIS Lecturer Guideline</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>EIS është një sistem i cili mundëson administrimin e të dhënave për studentët në kohë reale. Nga vizita në institucion, GVJ konstatoi se dokumentacioni e aktivitetet e personelit akademik, ndihmës akademik apo partnerëve menaxhohen nga zyra e burimeve njerëzore e cila ka një sistem informacioni të dedikuar.</p> <p><i>Annex No. 88 - Guidelines for the use of information technology infrastructure</i></p> <p><i>Annex No. 89- EIS Student Guideline</i></p> <p><i>Annex No. 90- EIS Lecturer Guideline</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë</p>	<p>Nga analiza e RVB dhe DVV dhe siç u konfirmua gjatë vizitës në institucion, EIS ofron akses të dedikuar në dokumentacionet e nevojshme duke pasur dy panele aksesit: paneli i dedikuar për stafin akademik dhe ndihmës dhe paneli i</p>

<p>personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>dedikuar për studentët.</p> <p>Nëpërmjet EIS, stafi akademik mund të realizojë funksione të ofruara nga modulet e sistemit, si psh.: modifikojë të dhënat personale në modulën “profilli im”, të kontrollojë klasat mësimore, të realizojë hedhjen e notave, të kontrollojë kërkesat për rishikim, të kontrollojë planet mësimore për çdo lëndë, etj.</p> <p><i>Annex No. 88 - Guidelines for the use of information technology infrastructure</i></p> <p><i>Annex No. 89- EIS Student Guideline</i></p> <p><i>Annex No. 90- EIS Lecturer Guideline</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga analiza e RVB dhe DVV dhe siç u konfirmua gjatë vizitës në institucion, EIS mundëson ndërveprimin mes aktorëve të institucionit duke lejuar hapjen dhe menaxhimin e adresave të emailit. Gjithashtu, gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se për të menaxhuar në mënyrë efektive procesin mësimor online, sidomos gjatë vitit akademik 2020-2021, institucioni zbatoi edhe platformën me komponentët e Google Classroom dhe Google Meet.</p> <p><i>Annex No. 88 - Guidelines for the use of information technology infrastructure</i></p> <p><i>Annex No. 89- EIS Student Guideline</i></p> <p><i>Annex No. 90- EIS Lecturer Guideline</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Nga analiza e RVB dhe DVV dhe siç u konfirmua gjatë vizitës në institucion, ISE në IAL mundëson kontrollin në kohë reale të frekuentimit të mësimin nga ana e studentëve dhe stafit. Megjithatë, siç edhe u konfirmua gjatë vizitës në institucion, sistemi nuk mundësonte gjenerimin e raporteve individuale dhe të dhëna në kohë reale përtej atyre mbi mësimdhënien.</p> <p><i>Annex No. 88 - Guidelines for the use of information technology infrastructure</i></p> <p><i>Annex No. 89- EIS Student Guideline</i></p> <p><i>Annex No. 90- EIS Lecturer Guideline</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin</p>	<p>Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik të përfshirë në të, aktivitetet e ndryshme të departamentit përgjegjës për këtë program studimi, gjenden në</p>

akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	faqen e web-it të institucionit. Në tërësi, GVJ konstatoi se informacionet online në lidhje me programin e studimit ishin të plota dhe të dobishme si për studentët aktual ashtu edhe për ata potencial. <i>Annex No. 79- Institutional policies for disclosure of information</i> <i>Annex No. 80- Data from the official WEB page</i>		
Konkluzione	GVJ vëren se institucioni disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit i cili është efektiv dhe mundëson një ndërveprim më të zhdërvjellët midis studentëve dhe institucionit në funksion të mësimdhënies e mësimnxënies.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga analiza e RVB, DVV dhe sidomos nga të dhënat e përftuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se IAL përcakton në Statut pikat që lidhen me buxhetin dhe aspektet financiare të institucionit ku identifikohen aktorët dhe proceset Specifikisht, bazuar në RVB dhe statut, buxheti hartohet nga administratori i universitetit bazuar në një plan afatmesëm, planin strategjik të zhvillimit të institucionit dhe nga propozimet e marra nga njësitë kryesore dhe ato bazë. Më tej buxheti aprovohet nga Bordi i Administrimit i cili, ndër të tjera, sigurohet që të jetë i realizuar në përputhje me

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës dhe aksesin në</p>	<p>standardet ligjore.</p> <p>Annex të detajuara mbi aspekte të ndryshme financiare të lidhura me të ardhurat dhe kostot gjendet në DVV si pjesë e të dhënave financiare institucionale.</p> <p><i>Annex No. 1- Statute of EPOKA</i></p> <p><i>Annex No. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i></p> <p><i>Annex No. 14- Autonomy, Academic and Financial Freedom</i></p> <p><i>Annex No. 87- Data from the Annual Institutional financial report related to the cost of the study program, Financial Plan for a full cycle of study</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Bazuar në RVB kjo gjë ndodh rregullisht. Gjithësesi GVJ nuk ka aftësitë teknike për ta vlerësuar diçka të tillë. Gjithësesi duke qenë një subjekt tregëtar i cili e ka për detyrim ta kryej auditim, GVJ beson që ai kryet sipas kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Annex No. 74- Department Last Annual Report</i></p> <p><i>Annex No. 75- Institutional last Annual Report</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se kontrolli buxhetor realizohet nga administratori dhe synon përdorimin efikas të burimeve të institucionit, në funksion të arritjes së objektivave. Sipas DVV, detyrë e administratorit është ndjekja dhe zbatimi i buxhetit vjetor dhe paraqitja në përfundim të cdo viti akademik para Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik të raportit të veprimtarisë financiare. Bazuar në analizën e DVV, GVJ konstaton se institucioni ka paraqitur një plan financiar institucional të krahasuar kundrejt buxhetit faktit.</p> <p><i>Annex 4. Rregullore e organizimit të IAL</i></p> <p><i>Annex 34. Raporti vjetor i institucionit</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme</p>	<p>Nga analiza e RVB, DVV dhe nga të dhënat e përfuara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se institucioni rezulton me fitim. Megjithatë nuk jepen informacione më të plota që të lejojnë GVJ të formojë një opinion të plotë në lidhje me qëndrueshmërinë financiare të institucionit.</p> <p><i>Annex No. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs</i></p>



për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	<i>Annex No. 75- Institutional last Annual Report</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni ka burimet financiare si dhe procedurat përkatëse të institucionalizuara në statut për financimin e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE



Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Për mbulimin e ciklit të plotë akademik të studentëve universiteti Epoka i përmbahet dispozitave ligjore në fuqi sic janë Ligji i Arsimit të Lartë udhëzimi “Për Miratimin e Kalendarit për Procedurat e Aplikimit dhe Rregjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë për Vitin Akademik Pasardhës”, por edhe dhe rregulloret të brendshme të hartuara nga institucioni sic janë Statuti dhe “Rregullorja Themelore”, i cili rregullon në mënyrë më të detajuar këto

	<p>procedura. Procedurat prezantohen përmes Udhëzuesit Inteligent të Studentit.</p> <p>Rregullorja Themelore përcakton politikat dhe procedurat në lidhje me kuotat e studentëve për çdo vit akademik në bazë të kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore të institucionit. Bazuar në aplikimet e marra përmes portalit U-Albania, EPOKA përgatit listën e studentëve fitues dhe pas publikimit në portalin e U-Albania ato publikohen edhe në faqen eeb të institucionit.</p> <p>Rregjistrimi i studentëve vendas dhe të huaj bëhet mbështetur në udhëzimin nr. 10 “Procedurat e aplikimit dhe rregjistrimit në IALS” dhe bazuar në “Kuotat e Pranimit”. Pas rregjistrimit të gjithë studentët pajisen me numër matriculimi nga QSHA dhe me kartën e studentit në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës. Ndërkohë për të ofruar një perspektivë të plotë të aktivitetit akademik, institucioni organizon ditë të hapura me studentët.</p> <p><i>(Annex Nr. 7- The Basic Regulation of EPOKA University</i></p> <p><i>Annex Nr. 78- Smart Student Guide</i></p> <p><i>Annex Nr. 47- Directive On Student Transfer</i></p> <p><i>Annex Nr. 49- Decision of the Administrative Board no. 1, dated 09.03.2022, Admission Quotas 2022- 2023..pdf</i></p> <p><i>Annex Nr. 50- Decision of the Academic Senate no. 2 dated 02.02.2022_ Admission Criteria_ 2023- 2024 academic year</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sic u shpjegua institucioni i referohet akteve ligjore kombëtare dhe atyre institucionale duke ndjekur këto hapa:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1) Aplikimet për të gjitha kategoritë e studentëve bëhen pranë Zyrës së Pranimit; 2) Zyra e Pranimit i dërgon dosjet e aplikimit pranë departamentit përkatës dhe vlerësohen nga një komision shkencor; 3) Epoka shpall listën e fituesve për çdo program studimi; 4) Kandidatët kryejnë rregjistrimin dhe koMShletojnë procesin e rregjistrimit; <p>Statuti (neni 117) dhe Rregullorja Themelore (neni 56) përmbajnë në mënyrë të detajuar të gjitha proceset nga rregjistrimi, deri tek perfundimi i studimeve apo transferimet</p>

	<p>në programe të tjera studimi duke ofruar transparencë në proces dhe barazi në trajtimin e studentëve. Të gjitha ambientet dhe godinat e institucionit janë pajisur me ashensorë ose me rampa për të mundësuar aksesin e personave me aftësi të kufizuara (<i>Vizita në institucion</i>).</p> <p><i>Annex Nr.1- Statute</i></p> <p><i>Annex Nr.7- The Basic Regulation of EPOKA University</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Institucioni harton dhe zbaton në rregjistrimin e studentëve në respekt të legjislacionit në fuqi sic janë Ligji 80/2015 miratuar nga MAS dhe Këshilli i Ministrave si edhe kuadrin ligjor institucional sic është vendimi i Senatit nr. 89 datë 27/01/2023. Universiteti shikon cdo vit listat e aplikantëve për secilin program dhe kryen renditjen e fituesve, në përputhje me kuotat e miratuara nga Ministria dhe i gjithë informacioni i referuar pranimit dhe transferimit publikohet në faqen kryesore të institucionit dhe në rrjetet sociale (https://admissions.epoka.edu.al/cat-master-admissions-1928.html).</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Senati Akademik referuar urdhërit të Ministrisë së Arsimit ka vendosur kuotat e pranimit të programeve të ciklit të dytë për vitin akademik 2023-2024. Pranimi në programet e studimit të Ciklit të Dytë është i mundur për cdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e parë të studimeve dhe plotëson kriteret e pranimit në universitet në përputhje me nenin 76 të ligjit nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë”, si edhe rregulloren e institucionit dhe konkretisht: a) studentët me diplomë bachelor ose ekuivalente; b) një CGPA minimale 2.50 nga 4.00; c) studentët që kanë përfunduar programet bachelor në universitetin Epoka me CGPA 2.00-2.49 nga 4.00; c) ose studentë që kanë përfunduar studimet në IAL të tjera me CGPA minimale 6.00-6.99 nga 10.00; d) nivel i gjuhës angleze B2 sipas CEFR dhe dëshmi të aftësisë së gjuhës angleze (TOEFL, IELTS, TOEIC, APTIS2, GESE).</p> <p>Në zbatim të udhëzimit të Ministrisë së Arsimit nr.10 datë 15/05/2019, cdo kandidat duhet të sjellë pranë sekretarisë mësimore dokumentat e mëposhtëm: a) formularin e aplikimit; b) letër motivimi; c) kopje të noterizuara të diplomës dhe listës së notave në bachelor; d) CV; e) një kopje të ID ose pasaportës; f) 4 fotografi pasaporte; g) certifikatën e</p>

		<p>mbrojtjes së gjuhës angleze (B2). Kriteret e pranimit janë publikuar në faqen zyrtare të universitetit, si edhe i prezantohen studentëve gjatë takimit në fillim të programit (https://admissions.epoka.edu.al/)</p> <p>Pranimi i transferimit të studentëve bëhet sipas legjislacionit në fuqi, ndërsa e studentëve për transferimin e krediteve vlerësohet nga një komision ad-hoc i ngritur në nivel departamenti dhe aprovohet nga dekani i fakultetit përkatës. Ky vendim bazohet në listën e notave dhe përshkrimin e secilës lëndë (syllabuse) të marra në universitetin ku ka ndjekur studimet. Sipas rregullores së IAL, komisionet nuk mund të njohin më shumë se 40 kredite transferimi për ciklin e dytë të studimeve në përputhje me Urdhërin e Këshillit të Ministrave n.41 datë 24/01/2018, pika 2.1.</p> <p><i>Annex Nr.50- Decision of Academic Senate no. 2 dated 02.02.2022: Admission Criteria 2023-2024 academic year</i></p> <p><i>Annex Nr. 45- Student Admission Procedures</i></p> <p><i>Annex Nr. 47- Directive on Student Transfer</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>		<p>Epoka informon lidhur me programet zyrtare përmes faqes ëeb (www.Epoka.edu.al) ku I ofrohet informacion jo vetëm publikut por edhe studentëve të Epoka, dhe stafit, lidhur me programet e studimit, karakteristikat e tyre, kurrikulat, si edhe aktivitetet studentore, kulturore dhe shkencore të organizuara nga institucioni.</p> <p>Një sërë aktivitetesh marketingu si reklama, orë të hapura, takime promovuese, të organizuara nga Epoka apo publikime si broshuara, students-book, etj synojnë tërheqjen e sa më shumë studentëve. Për të tërhequr më shumë maturantë, EPOKA organizon orë të hapura, takime maturantët dhe merr pjesë në panaire tematike. Universiteti organizon edhe provimin e bursës për t'u dhënë studentëve ekselentë mundësinë për të përfituar 100% bursë gjatë periudhës së studimeve.</p> <p><i>Annex Nr. 26- Marketing Policy</i></p> <p><i>Annex Nr. 51- Schemes for the Award of Master Scholarships</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo</p>		<p>Institucioni publikon në fillim të cdo viti kuotat në dispozicion të studentëve që vijnë nga disa kategori te vecanta</p>

<p>viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>sociale, në zbatim të kriterëve që janë vendosur nga Ministria e Arsimit në udhëzimin nr. 17, datë 30/07/2019.</p> <p>Epoka është partner në projektin IDEA të Erasmus+ me qëllim përmirësimin e aksesit dhe krijimin e kushteve gjithëpërfshirëse të mësimdhënies dhe zhvillimit të mundësive të punësimit për studentët me aftësi ndryshe.</p> <p><i>Annex Nr. 103- Accesibility Team</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Kuotat e pranimit për studentët me shtetësi të huaj publikohen përpara çdo viti akademik dhe kriteret që ndiqen janë ato të publikuara nga Ministria e Arsimit për këtë qëllim. Kandidatës me shtetësi të huaj duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar në vendimin përkatës të Keshillit të Ministrave për pranimin në programet e ciklit të parë dhe të dytë.</p> <p><i>Annex Nr. 50- Decision of Academic Senate no. 2 dated 02.02.2022 Admission Criteria 2023-2024 academic year</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Komiteti i Bursave ofron mbështetje financiare pas vlerësimit të dokumentacionit të dorëzuar pranë institucionit. Sipas legjislacionit të IAL, kandidatët mund të përfitojnë bursa në bazë të këtyre kriterëve: mesatarja e programit bachelor: a) CPGA 2.70-2.99 përfitojnë 10% të bursës; b)) CPGA 3.00-3.29 përfitojnë 20% të bursës; c)) CPGA 3.30-3.49 përfitojnë 30% të bursës; d) CPGA 3.50-3.99 përfitojnë 40% të bursës; e) nëse CPGA është 4 ose më e lartë studenti përfiton 50% të bursës. Po kështu përfitojnë bursë studentët me arritje kombëtare dhe ndërkombëtare, fëmijët e policëve të vrarë në krye të detyrës, fëmijët jetimë të ardhur nga familje me të ardhura të ulëta, studentët që i përkasin komunitetit rom, egjiptian, si edhe studentë nga Bashkia Vorë.</p> <p><i>Annex Nr. 51- Schemes for Awards of Master Scholarships</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Epoka ka hartuar dhe zbaton procedura dhe politika të qarta për pranimin e studentëve në programet akademike dhe përzgjedhjen e tyre në bazë të legjislacionit në fuqi. Një kujdes i vecantë tregohet për matjen e përparimit të studentëve duke zbatuar forma të ndryshme të vlerësimit si gjatë vitit akademik ashtu edhe në përfundim të tij. Epoka ka një legjislacionin të qartë institucional për transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e</i></p>

	<i>studimit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet sërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Studenti njihet me rregulloren e programit, e cila përcakton kriterit e kalimit nga një vit akademik në tjetrin në varësi të përmbushjes së kërkesave akademike. Informacioni zyrtar mbi notat është pjesë e sistemit të menaxhimit të universitetit. Falë Sistemit Interaktiv Epoka EIS, stafi akademik me kohë të plotë dhe studentët kanë akses në sistemin e menaxhimit jo vetëm për të regjistruar notat por edhe njohur me rezultatet e arritura si edhe për të verifikuar ecurinë e studentëve dhe për të bërë këshillimet e nevojshme mbi progresin akademik</p> <p><i>Annex Nr. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i></p> <p><i>Annex Nr. 7- The Basic Regulation of EPOKA University</i></p> <p><i>Annex Nr. 78- Smart Student Guide</i></p>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	<p>Zyra e Rregjistrimit ofron informacion mbi procedurat e njohjes së diplomës apo të krediteve të përfituara nga institucione të tjera në bazë të kuadrit ligjor të miratuar nga Ministria Arsimit dhe Sportit, por edhe informacioni shtesë për studentët e huaj duke shpjeguar udhëzime mbi procedurat e transferimit kriteret sic u sqarua më lart për njohjen e krediteve, duke informuar më pas studentin për kreditet e njohura nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Kreditet e transferuara të studentëve hyjnë në fuqi me miratimin e Dekanatit.</p> <p><i>Annex Nr. 47, Directive On Student Transfer</i></p>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje	<p>Neni 37 i "Rregullores për Programet e Studimeve të Ciklit të Dytë informon studentët për kriteret dhe procedurat e</p>

<p>me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>vlerësimit të njohurive dhe aftësive gjatë programit të studimit. Epoka operon me sistemin Evropian të Arsimit të Lartë të Krediteve si njësi matëse e ngarkesës akademike. Mënyrat e vlerësimit të njohurive të programit si edhe kriteret e vlerësimit janë përcaktuar në Rregulloren e Programit. Në një lëndë tipike dijet e përfituara vlerësohen sipas këtij klasifikimi: a) Provimi i Ndërmjetëm; b) Provimi Përfundimtar; c) Pjesmarrje aktive e studentit në klasë; d) KoMShonentë të tjerë si detyra kursi, projekte studimore.</p> <p><i>Annex Nr. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i></p> <p><i>Annex Nr. 78- Smart Student Guide</i></p> <p><i>Annex Nr. 32- Guidelines on Examinations</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Neni 41 i Rregullores së Programit të Studimit të Ciklit të Dytë dhe neni 56 i Rregullores Themelore e Universitetit Epoka përcaktojnë parakushtet i.e. nota mesatare 2.00 dhe nuk ka asnje note FD dhe FF duke përfunduar të gjitha kurset - kriteret dhe procedurat për projektin e diplomimit. Informimi i studentëve lidhur me këto kërkesa dhe procedura është detyrë e departamentit. Për të plotësuar këto parakushte, studentët kanë të drejtë të hyjnë në provime plotësuese jo më shumë se tre herë. Studentët paraqesin një dokument që i kanë kryer të gjitha detyrimet prej 120 ECTS për të marrë diplomën e masterit shkencor</p> <p><i>Annex Nr. 2- Regulation 'On Second Cycle Study Programs'</i></p> <p><i>Annex Nr. 7- The Basic Regulation of EPOKA University</i></p> <p><i>Annex Nr. 52- Diploma Format</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Institucioni organizon dhe zhvillon takime me studentët bachelor për tu ofruar atyre informacionin e nevojshëm mbi programet e studimit në programet master. IAL merr pjesë në panairë të organizuara ku ofron udhëzime dhe informacione për kandidatët e mundshëm</p> <p><i>Annex Nr. 46- Marketing Policy</i></p>

Konkluzione	<i>LAL ofron mjete të ndryshme për njohjen e programit nga ana e studentëve dhe këto përfshijnë si transparencën online me informacion të hollësishëm për programin e studimit, javën hyrëse ku pedagogët pjesmarrës japin informacionin e nevojshëm dhe zyrën pranimit që shërbejnë si pikë reference për studentëve e programit të studimit për të dhënë një informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programin në fjalë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht
			X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Neni 89 i Statutit të Universitetit përcakton karakteristikat e programit te ciklit të dytë. Zyra e Pranimit informon studentët mbi strukturën e programeve duke harmonizuar takimet në zyrë me faqen zyrtare https://admissions.epoka.edu.al/home-master-of-science-1928-1930.html ku studentët gjejnë të gjithë informacionet e nevojshme mbi programet e studimit, sic jane kohëzgjatja e programit, tarifat e studimit, përbërja e lëndëve etj <i>Annex Nr.1- Statute of University</i> <i>Annex Nr. 4- Curricula of the study program</i> <i>Annex Nr. 5- Course Syllabi</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentit i ofrohet i gjithe informacioni i nevojshëm si syllabuset që në javën e parë të studimeve, ndërsa cdo student ndiqet nga një pedagog që është pjesë e departamentit. Studentëve ky informacion mund ti online nëpërmjet programit EIS (https://epoka.edu.al/home-academics-master-programs-2-1000.html) por edhe i printuar, si edhe u krijohet mundësia për tu takuar me pedagogët dhe për të marrë më shumë informacion mbi programin. Studentët informohen

	<p>gjithashtu edhe për akreditimin e programeve dhe të institucionit dhe vlefshmërinë e diplomes.</p> <p>Annex Nr. 4- Curricula of the study program</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Epoka ka një Zyrë për Planifikimin e Karrierës dhe të Diplomuarve (https://epoka.edu.al/governance/home.html), e cila informon studentët –sikunder u theksua edhe në takimet me studentët dhe me Përfaqësues së Zyrës së Karrierës–në lidhje me nevojat e tregut të punës duke ofruar seanca këshillimore për studentët që duhet të njihen me mundësitë e punësimit apo praktikave që mund të ndjekin pranë institucioneve të ndryshme. Një nga aktivitetet më të rëndësishme të Zyrës së Planifikimit të Karrierës është organizimi i Sesioneve Informative, Panairi i përvitshëm i Karrierës, i cili bashkon përfaqësues të institucioneve publike, biznesit, por edhe Alumni të diplomuar pranë Epoka. Në Panairin e fundit morën pjesë 100 koMShani, të cilat ofruan mundësi punësimi apo projektsh studimore për studentët</p> <p>Annex Nr. 69- List of Partnership Agreements</p> <p>Annex Nr. 93- Summary Tables</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Një përshkrim i plotë i ambienteve të logjistikës ofrohet që në fillim të programit, ndërsa gjatë vizitave të organizuara në institucion, studentët apo kandidatët informohen mbi shërbimet e ofruara për studentët, informacionet lidhur me programin e studimit, logjistika institucionale, etj. Sic u theksua edhe në takimin me Stafin Akademik të Programit, këto informacione ofrohen edhe gjatë ditëve të hapura të organizuara në fillim të cdo viti akademik për këtë qëllim nga të gjitha strukturat e IAL në shërbim të studentit por edhe nga pedagogu gjatë javës së parë në prezantimin e cdo lënde.</p> <p>Annex Nr. 78- Smart Student Guide</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Pasi studentët rregjistrohen në Epoka, Zyra Kordinuese e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit u siguron një emër përdorimi dhe kod për të patur akses në listën e tyre të notave, mungesat e kryera, si edhe situatën e tyre financiare. Kjo procedurë kryhet në sistemin e menaxhimit (EIS) dhe aksesit i mundësohet në cdo ambient nga ku mund të ketë lidhje me internet.</p> <p>Annex No. 89- EIS Student Guideline</p>



Konkluzione	<i>Struktura dhe organizimi i programit janë publike dhe mund të aksesohen nga studenti si online ashtu edhe nëpërmjet broshurave apo edhe komunikimit me stafin akademik dhe atë ndihmës të programit. Përtej programit të studimit, organizohen me ndihmën e partnerëve institucionalë edhe panairë për tu dhënë mundësi studentëve të njohin tregun e punës. Programet e studimit dhe syllabuset përkatëse janë në dispozicion të studentëve duke përfshirë si format e vlerësimit objektivat mësimore që pritet të arrihen në përfundim të kursit, por edhe mënyrën e vlerësimit të përmbushjes së këtyre objektivave formuese.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Statistikat mbi numrin e studentëve, shpërndarjen sipas programeve, notat e marra, studentët e diplomuar dhe ata të dalluar, përgatiten çdo vit nga Zyra e Regjistrimit. Këto të dhëna dokumentohen në “Raportin Vjetor”, i cili përgatitet nga Zyra e Karrierës si pjesë e detyrimit ligjor të IAL. Të dhënat që përpunohen nga Zyra e Karrierës përfshijnë punësimin e studentëve, si edhe përputhshmërinë e punësimit me drejtimin e diplomimit. <i>Annex Nr. 75- Annual Report</i> <i>Annex Nr. 93- Summary Tables</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet	Sistemi i menaxhimit të të dhënave mundëson përditësimin dhe hedhjen e të dhënave personale të studentëve në performancën akademike dhe në situatën financiare, përfshirë edhe studentët e regjistruar dhe të larguar. Në këtë mënyrë krijohet një tablo në kohë reale e studentëve që janë në programet e studimit, atyre që janë shkëputur përkohësisht apo përgjithmonë (<i>Tabela Përmbledhëse 21 dhe 23.1, 23.2, 23.3</i>)

<p>para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p><i>dhe 23.4).</i> Ky përditësim ndihmon Sekretarinë Mësimore që të ofrojë të dhëna të sakta që nevojiten si për zbatimin e legjislacionit në fuqi ashtu edhe raporteve apo studimeve të kryera nga vetë institucioni.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e DVV dhe vizitës në institucion numri i studentëve për këtë program studimi për katër vitet akademike është si më poshtë vijon:</p> <table border="1" data-bbox="576 501 1302 801"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Nr i të regjistruarve</th> <th>Nr i të cregjistruarve</th> <th>Nr aktual</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2019-2020</td> <td>9</td> <td>-</td> <td>9</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>12</td> <td>2</td> <td>10</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>5</td> <td>-</td> <td>5</td> </tr> <tr> <td>2022-2023</td> <td>5</td> <td>-</td> <td>5</td> </tr> </tbody> </table> <p><i>Annex Nr. 75- Annual Report</i></p> <p><i>Annex Nr. 93- Summary Tables</i></p>	Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të cregjistruarve	Nr aktual	2019-2020	9	-	9	2020-2021	12	2	10	2021-2022	5	-	5	2022-2023	5	-	5
Viti akademik	Nr i të regjistruarve	Nr i të cregjistruarve	Nr aktual																		
2019-2020	9	-	9																		
2020-2021	12	2	10																		
2021-2022	5	-	5																		
2022-2023	5	-	5																		
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Për të mbrojtur të dhënat personale të studentëve, të cilat menaxhohen përmes platformës së brendshme EIS, aksesit si për departamentet ashtu edhe zyrat e tjera bëhet në bazë të rregulloreve dhe përgjegjësi përkatëse. Sekretaria mësimore e perdor këtë platformë jo vetëm për të hedhur të dhëna por edhe për të vënë në dispozicion të dhënat që nevojiten për analizat, raportet apo hartimin e strategjive të institucionit</p> <p><i>Annex Nr. 79-, Institutional Disclosure Information</i></p>																				
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me</p>	<p>Për të kryer auditimin e brendshëm të njësive administrative, insitucioni ka ngritur Grupin e Auditimit të Brendshëm, i cili ka si objektiv kontrollin në mënyrë periodike të procedurave dhe rregullave të përshkruara në rregulloren e funksionimit të zyrave administrative. Grupi i Auditimit përpilon një raport vjetor ku përfshihen mangësitë e vërejtura si edhe ofrohen sugjerime për përmirësimin e tyre duke u udhëhequr nga Politika e Cilësisë</p> <p><i>Annex Nr. 10- Decision of the Rectorate On the Establishment of the Internal Audit Group</i></p> <p><i>Annex Nr. 53- Quality Policy</i></p>																				

veprimtarinë e tyre përkatëse.									
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>Sic u përmend më lart, Zyra e Rregjistrimit përgatit cdo vit dhe vë në dispozicion të Departamentit përkatës të dhënat e nevojshme për hartimin e raporteve dhe analizave përsa i takon numrit të studentëve të regjistruar dhe diplomuar, apo shkëputur nga programet e studimit. Ndërkohë Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Diplomuarve siguron bazën e nevojshme të të dhënave për studentët e diplomuar duke kontribuar në hartimin e raporteve të ndryshme dhe ofrimin e një pasqyre të studentëve të diplomuar, punësimin e tyre dhe profilet e punësimit. Nga të dhënat e kësaj Zyre vërehet se numri i studentëve të punësuar plotësisht në profilin e tyre është 68% sic shpjegohet në Tabelat Përmbledhëse 23.1, 23.2, 23.3 dhe 23.4.</p> <p><i>Annex Nr. 95- Alumni Survey Questionnaire Form</i></p> <p><i>Annex Nr. 93- Summary Tables</i></p>								
Konkluzione	<i>Institucioni bën një punë të vazhdueshme me ndihmën e zyrave administrative për të mbledhur, administruar, përditësuar dhe ruajtur të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</i>								
Shtylla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet plotësisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet jo plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet jo plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet jo plotësisht						
			X						

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet	Në nenin 118 të Statutit, IAL saknksionon pjesmarrjen e studentëve në vendimmarrjet institucionale. Këshilli Studentor është organizatë e pavarur që zgjidhet nga vetë studentët dhe përfaqëson interesat e tyre. Në Statutin e Këshillit parashikohet edhe përfshirja e një studenti të zgjedhur nga

<p>vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Këshillit Studentor në komisionin disiplinor, ndërsa parashikohet shmangia mundshme e konfliktit të interesit në përzgjedhjen e studentëve në instancat vendimmarrëse të institucionit.</p> <p><i>Annex Nr. 1- Statuti of University</i></p> <p><i>Annex Nr. 55- Statute of Student Council</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Epoka saknsonon në aktet ligjore institucionale të drejtën e studentëve për tu përfaqësuar në vendimmarrje në instanca si: Senati Akademik, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Bordi i Etikës, dhe Komisioni i Përhershëm për Marrëdhëniet me Studentët. Një student është gjithashtu pjesë e grupit të punës për hartimin e raportit të Vlerësimit të Brendshëm gjatë procesit të akreditimit sic u pa edhe në takimin me Grupin e Punës për Hartimin e RVB.</p> <p><i>Annex Nr. 55- Statute of Student Council</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupë fokusimi, etj.</p>	<p>Si anëtarë të Senatit Akademik dhe Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, që janë organet kompetente për hartimin dhe kontrollin e zbatimit të programit, studentët janë pjesë e procesit të hartimit dhe përmirësimit të programeve sipas nenit 15 të Statutit. Studentët kontribuojnë gjithashtu edhe nëpërmjet mendimeve që japin në anketat pas përfundimit të lëndës dhe në takimet me pedagogët përkatës.</p> <p><i>Annex Nr. 1- Statuti of University</i></p> <p><i>Annex Nr. 31- Course Instructor Evaluation Survey</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njësish/pedagogut</p>	<p>Studenti ka të drejtën e ankimimit për notën e provimit brenda 5-ditëve nga marrja e notës. Zyra e Rregjistrimeve merr në shqyrtim ankesën e dorëzuar nga studentët por edhe mbledh të gjitha të dhënat përkatëse lidhur me ankesën apo kërkesën e paraqitur nga studenti dhe e paraqet pranë pedagogut të lëndës, i cili rishikon vlerësimin nëse kjo është e arsyeshme.</p> <p>Sikunder GVJ u informua në takimin me Studentët e Programit, keta të fundit nëpërmjet Këshillit Studentor paraqesin ankimet e tyre për çdo element të aktivitetit të tyre në institucion, të cilat merren në shqyrtim nga instancat</p>

përgjegjës.	përkatëse institucionale. <i>Annex Nr.40- Grade Appeal Form</i> <i>Annex Nr. 32- Guideline on Examinations</i>		
Konkluzione	<i>Epoka i kushton rëndësi mbledhjes së informacionit nga ana e studentëve dhe kjo arrihet si nëpërmjet pyetësorëve të lëndës ashtu edhe procesit të ankimit apo prurjes së sugjerimeve nga ana e tyre. Kjo realizohet edhe falë përfshirjes dhe angazhimit të studentëve në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre. Ky proces zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme dhe me përfshirjen e të gjitha organeve të universitetit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Zyra e Rregjistrimit, Zyra e Dekanit të Studentëve dhe Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe të Diplomuarve ofrojnë informacionin e plotë të nevojshëm për studentët, si edhe mbajnë kontakte të vazhdueshme me ta, për të siguruar një shërbim sa më të mirë ndaj tyre. Të gjitha shërbimet dhe informacionet janë të përcaktuara në Rregulloren Themelore të Institucionit, ndërsa Zyra e Rregjistrimit ndjek të gjithë progresin akademik të studentëve. <i>Annex Nr. 7- The Basic Regulation of EPOKA University</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin,	Zyra e Rregjistrimit informon studentët përmes emaileve, takimeve në zyrë, broshurave apo përmes dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet sistemit EIS, ditës së orientimit për studentët e rinj por edhe faqes së internetit, informacionet

<p>këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>lidhur me karakteristikat e programit të studimit, që përditësohen në kalendarin akademik https://epoka.edu.al/home-academics-academic-calendar-2-34.html. Studentët mund të kenë edhe takim me pedagogët apo pjestarët e stafit akademik përgjegjës për programin, ndërsa informacioni më i detajuar lidhur me planin mësimor, syllabus i lëndëve, datat e provimeve etj ofrohet nga këshilluesi akademik</p> <p><i>Annex Nr. 78- Smart Student Guide</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me koMShletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Planifikimit të Karrierës fokusohet në përthithjen e nevojave të tregut të punës dhe këshillimin e studentëve dhe strukturave akademike të universitetit lidhur me këto nevoja, dhe ndan këtë informacion si me Zyrën e Cilësisë ashtu edhe me departamentet përkatëse, por edhe këshilltarët akademikë, në mënyrë që programet e studimit të përgatisin studentë me profile sa më të kërkuara në tregun e punës.</p> <p>Kjo Zyrë i ofron studentëve këshillat e nevojshme lidhur me mundësitë e karrierës nëpërmjet takimeve individuale, panairove dhe workshopeve tematike të organizuara për këtë qëllim, si edhe nëpërmjet informacionit të publikuar lidhur me analizat mbi tregun e punës, të cilat publikohen në të gjitha kanalet e institucionit në bashkëpunim me Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun</p> <p><i>Annex Nr. 104- Report on Alumni Survey</i></p> <p><i>Annex Nr. 46- Marketing Policies</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Në database të Zyrës së Karrierës dhe Alumni përfshihen të gjithë studentët e diplomuar në të gjitha nivele akademike, si edhe identifikohet niveli i punësimit për këta studentë duke e integruar në analizën e Anketës së të Diplomuarve që përgatitet në përfundim të çdo viti akademik duke përfshirë: statusin e punësimit, institucionet e punësimit, si edhe rekomandimet që ata mund të kenë në lidhje me përmirësimin e programit. Ky informacion ndahet me drejtuesit e programeve, dekanët dhe rektoratin për të parë se çfarë mund të përmirësohet në të ardhmen. Kontaktet me industrinë dhe insitucionet mbahen nga kjo Zyrë falë edhe kontakteve që ata kanë në mënyrë të vazhdueshme me Alumni por edhe anketës që organizohet me institucionet publike dhe kompanitë ku</p>

	janë punësuar studentët			
	<i>Annex Nr. 104- Report on Alumni Survey</i>			
	<i>Annex Nr. 96- EPOKA Company Satisfaction Survey Form</i>			
Konkluzione	<i>Universiteti Epoka ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve sic janë keshilltari akademik apo edhe pedaogët e lëndës të cilët së bashku me zyrat ndihmëse ofrojnë të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët. Një procedurë e vecante siguron menaxhimin e ankimeve e problematikave, nga strukturat përkatëse sic është Zyra e Dekanit të Studentëve, struktura të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme dhe janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
			X	

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës V	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht	
			X	

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Strategjia institucionale e mësimdhënies, mësimnxënies dhe metodave të vlerësimit 2020-2025 përfshin integrimin e teknologjive të avancuara, rishikimin e programeve mësimore, jo vetëm për të sanksionuar këto aktivitete por edhe për t'iu përgjigjur nevojave të tregut. Për aplikimin e këtyre strategjive, stafi institucionit merr pjesë në trainimet e organizuara nga NJSBC dhe ekspertët e jashtëm. Ky training fokusohet tek mobiliteti i stafit – falë përfshirjes së

	<p>universitetit ne Projektin “Shkëmbimi Virtual i Universiteteve Shqiptare dhe Europiane” jo vetëm për të rritur kapacitetet profesionale të tij, por edhe për të krijuar më shumë mundësi për ndërkombëtarizim.</p> <p>Punë e vecantë bëhet për trainimin e stafit në mënyrë periodike dhe nxitjen e zhvillimit të vetëvlerësimit kritik, sidomos me pedagogët e rinj të cilët trainohen për mënyrëe e përgatitjes së programeve, kurrikulave dhe shpjegimin e rregulloreve përkatëse (17). Programet dhe platformat online si për shembull Hyflex janë gjithashtu një tjetër mundësi që ka stafi dhe studentët për tu njohur me metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p><i>Annex Nr. 12- Epoka University Strategy 2018-2022</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë, (KPSC) Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) dhe Departamentet përkatëse në cdo fakultet, përbëjnë strukturat përgjegjëse për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin në mënyrë të vazhdueshem të cilësisë. KPSC është përgjegjës për koordinimin e procedurave të përgjithshme lidhur me vlerësimin e brendshëm dhe të jashtëm të njësive akademike dhe atyre mbështetëse për studentët për të garantuar respektimin e dispozitave ligjore në fuqi. Nën monitorimin e KPSC, NJSBC harton pyetësorët për studentët, të cilët kryhen dy herë në vit.</p> <p>Rezultatet e anketave u vihen në dispozicion rektoratit, drejtuesve të departamentit, dhe përfshihen në raportin vjetor të departamentit, ku paraqiten vlerësimet për stafin akademik dhe ndihmës-akademik, si edhe trainimet e ofruara. Të gjitha këto vlerësime diskutohen në prani të përgjegjës të departamentit.</p> <p><i>Annex Nr. 43- Quality Assurance Handbook</i></p> <p><i>Annex Nr. 28- Directive Academic and Administrative Performance Assessment and Quality Improvement</i></p> <p><i>Annex Nr. 31- Course Instructors Evaluation Survey</i></p> <p><i>Annex Nr. 44- Regulation On The Organization and Functioning of the PCQA</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e</p>	<p>IAL inkurajon përfshirjen e studentëve në vlerësimin e metodave të mësimdhënies, si edhe ofrimin e sugjerimeve nga</p>

<p>studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>studentët duke e konsideruar si një shtytës për të arritur objektivat e mësimdhënies. Këto pyetësore jo vetëm që përmirësojnë metodologjitë mësimore, por edhe sjellin në vëmendje pakënaqësitë e studenteve, ndërsa mënyra për ta shprehur shqetësimet apo sugjerimet e studentëve ekziston nëpërmjet procesit të ankimimit pranë Dekanit të Studentëve.</p> <p><i>Annex Nr. 31- Course Evaluation Survey</i></p> <p><i>Annex Nr. 106- Student Request Form</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Në kuadër të transparencës institucionale, KPSC dhe NJSBC publikon raportet përfundimtare të akreditimit të programeve të studimit në faqen zyrtare të IAL duke përfshirë edhe raportet e grupit të vlerësimit të brendshëm https://aeqi.epoka.edu.al/home-internal-evaluation-reports-accreditation-1479-1480.html?lang=EN&dpid=2&t=internal-evaluation-reports-accreditation&catid=1479&menuid=1480 dhe atë të jashtëm https://aeqi.epoka.edu.al/home-external-evaluation-reports-accreditation-1479-1481.html?lang=EN&dpid=2&t=external-evaluation-reports-accreditation&catid=1479&menuid=1481.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Për të nxitur zhvillimin profesional, IAL mundëson për vlerësimin e stafit duke përcaktuar objektivat e tyre për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor nëpërmjet “Formularit të Matjes dhe Vlerësimit të Performancës Akademike” i cili ka 5 nivele dhe pedagogët duhet të arrijnë nivelin 3.0-3.5 për tu konsideruar se përmbushin pritshmëritë.</p> <p>Koordinatori i departamentit ia percjell këto raporte dekanit, duke i kërkuar pedagogëve që të vlerësojnë se si janë plotësuar këto objektiva, ofron trainimet e nevojshme për ti nxitur pozitivisht performancën individuale të çdo pedagogu dhe vendos për promovimin e pdegaogut dhe mbështjetjen për kërkimet shkencore, pjesmarrjen në konferenca etj. Këto vlerësime i shtohen atyre nga kolegët, studentët, takimet personale me stafin akademik, etj.</p> <p><i>Annex Nr.28- Directive Academic and Administrative Performance Assessment and Quality Improvement</i></p> <p><i>Annex Nr. 29- Academic Performance Measurement and Assessment Form</i></p> <p><i>Annex Nr. 107- Academic Staff Satisfaction Survey</i></p>

Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet krijimit të strukturave përkatëse sic janë KPSC apo edhe NJSBC, metodologjitë dhe mjetet përkatëse për të zhvilluar këtë monitorim, si edhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave të monitorimit, trainimit dhe përmirësimit të mëtejshëm të performancs së stafit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmirësim i menjëhershëm	Përmirësim kryesisht	Përmirësim plotësisht
			X

Standardi VI.2



Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Sic u shpjegua më lart Epoka ka strukturat e nevojshme të sigurimit të cilësisë por edhe procedurat e zhvilluara për këtë qëllim në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtare. Kjo sanksionohet edhe në Statutin e Universitetit (neni 35 dhe neni 37) ku përcaktohet roli i strukturave bazë sic janë KPSC dhe NJSBC, por edhe nën-strukturave ndihmëse sic janë Komisioni i Zhvillimit të Programeve Mësimore, Bordi i Provimeve, Bordi i Vlerësimit të Performancës Akademike dhe Përmirësimit të cilësisë ku rritja e cilësisë akademike, mësimdhënia por edhe shërbimet paraqiten si objektiva strategjike. Për të mbështetur më tej zbatimin e këtyre procedurave KPSC ka hartuar edhe rregulloren përkatëse si edhe Manualin e Sigurimit të Cilësisë dhe Rregulloren për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë</p> <p><i>Annex Nr. 43- Quality Assurance Handbook</i></p> <p><i>Annex Nr. 44- Regulation On The Organization and Functioning of the PCQA</i></p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të	Strukturat e sigurimit të cilësisë KPSC dhe NJSBC funksionojnë në zbatim të ligjit për arsimin e lartë, statutin e institucionit dhe rregulloret përkatëse të harmonizuara me

<p>Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Manualin e Cilësisë. KPSC përbëhet nga anëtarë të stafit akademik eksperti i jashtëm dhe një përfaqësues i studentëve, ndërsa NJSBC përbëhet nga dy anëtarë të stafit administrativ dhe një ekspert i jashtëm me profil akademik (<i>Tabelat Përmbledhëse 24</i>). I zgjedhur nga Senati akademik KPSC së bashku me NJSBC janë strukturat përgjegjëse për kontrollin e cilësisë (<i>neni 35</i>). NJSBC në bashkëpunim me fakultetet/departamentet organizon e finalizon formën e vlerësimit dhe performancën e pedagogut (<i>Takim me përfaqësues të NjsBC</i>). Të dhënat përpunohen nga korrdinatori i NJSBC dhe përfshijnë të gjitha format e vlerësimit për pedagogun dhe përfshihen në raportin përfundimtar të departamentit, i cili është i aksesueshëm në faqen zyrtare të IAL.</p> <p>NJSBC në bashkëpunim me drejtuesit e njësive aplikon, koordinon dhe finalizon të gjithë procedurën e akreditimeve institucionale, Planin Strategjik Pesëvjeçar si edhe Planin e Veprimit brenda institucionit.</p> <p><i>Annex Nr. 93- Summary Tables</i></p> <p><i>Annex Nr. 1- Statute of University</i></p> <p><i>Annex Nr. 29- Academic Performance Measurement and Assessment Form</i></p> <p><i>Annex Nr. 43- Quality Assurance Handbook</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Manuali i Sigurimit të Cilësisë është dokumenti bazë për KPSC për të siguruar cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet nëpërmjet proceseve të akreditimit, dhe Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë është dokumenti kryesor për këtë qëllim në përputhje me nenin 104 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shekncor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. Për të plotësuar sa më mirë rekomandimet e lëna gjatë akreditimeve, KPSC dhe NJSBC hartojnë një plan që ndjek në vijimësi zbatimin e këtyre rekomandimeve.</p> <p><i>Annex Nr. 43- Quality Assurance Handbook</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni</p>	<p>Strukturat e ngarkuara për sigurimin e cilësisë gjenerojnë</p>

<p>përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>analiza dhe raporte të vazhdueshme duke përfshirë format e vlerësimit të pedagogëve të përmendura më lart, të cilat realizohen nëpërmjet zbatimit të “Direktivës për Vlerësimin e Performancës Akademike dhe Administrative dhe Përmirësimin e Cilësisë”. Raportet i dorëzohen Koordinatorit të Departamentit, Dekanit dhe Rektoratit duke përfshirë edhe rekomandimet përkatëse të NjsBC dhe KPSC për përmirësimin e mëtejshëm të punës.</p> <p>Për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë, secili anëtar i stafit akademik përvec mësimdhënies është i angazhuar edhe në kërkimin shkencor, në grupet e punës akademike dhe në projekte mobiliteti si Erasmus+ apo Cost dhe kjo vecanërisht pëe pedagogët e rinj, të cilët për një periudhë tre vjecare kanë një buxhet vjetor prej 750 euro për të financuar pjesmarrjen e tyre në aktivitete shkencore dhe akademike</p> <p><i>Annex Nr. 28- Directive Academic and Administrative Performance Assessment and Quality Improvement</i></p> <p><i>Annex Nr. 67- List of University Sponsored Participation in Scientific Activities</i></p>						
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Epoka harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit duke harmonizuar forma të ndryshme të monitorimit, si anketat e studentëve, vlerësimin e pedagogëve, rezultate të cilat harmonizohen në raportet përkatëse dhe zbatohen me udhëzimet e nevojshme nga strukturat e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</i></p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="566 1294 751 1391">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="751 1294 938 1391">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="938 1294 1125 1391">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="566 1391 751 1442"></td> <td data-bbox="751 1391 938 1442"></td> <td data-bbox="938 1391 1125 1442" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

<p>Standardi VI.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor</p>	<p>Departamenti mbetet struktura përgjegjëse për mbarëvajtjen e programeve përkatëse të studimit. Procesi i mbikqyrjes së</p>

<p>mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>programeve të studimit dhe stafit akademik bazohet në analizën e objektivave të vendosura si në nivel individual ashtu edhe në nivel departamenti për tu plotësuar gjatë vitit akademik duke u bazuar në Politikën për Përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit. Në përfundim të vitit akademik nga dekanati kërkohet hartimi i raporteve në nivel departamenti dhe fakulteti, ku përshkruhen të gjitha aktivitetet e kryera për përmbushjen e këtyre objektivave, si edhe propozimet për përmirësimin e programeve mësimore, të cilat miratohen përfundimisht nga Senati Akademik. IAL kryhen analiza vjetore për vlerësimin e ecurisë së studentëve në programet e studimit, ku përfshihen të dhëna për aspektet akademike dhe performancën e studentëve, nivelin e kalueshmërisë, shkallën e diplomit dhe punësimit, etj, të cilat pasi mblidhen nga strukturat përkatëse integrohen në raportet vjetore të njësisë bazë. Të gjitha raportet e hartuara kombinohen në raportin përfundimtar institucional, i cili miratohet në Senat dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit. I gjithë ky proces dokumentohet në të gjitha hapat e tij, për të siguruar transparencën e nevojshme dhe një proces gjithëpërfshirës për promovimin e praktikave pozitive.</p> <p><i>Annex Nr. 27- Policy on Continuous Improvement of Study Program</i></p> <p><i>Annex Nr. 101- Curriculum Change Proposal Form</i></p> <p><i>Annex Nr. 75- Institutional last Annual Report</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Përfshirja e studentëve me sugjerimet e tyre falë anketave të pergatitura 2-3 herë në vit, kontributin e Dekanit Studentor, si edhe komunikimin e vazhdueshëm të studentëve dhe pedagogëve krijon mundësinë e përfshirjes së pritshmërive në ardhmen. Sic u theksua edhe në takimin me stafin akademik të programit, kjo praktikë bashkërendohet si me vlerësimet e jashtme falë edhe anëtarit të jashtëm të KPSC- sic u përmend më lart, por dhe duke harmonizuar dhe shpërndarë përvojën e përparuar brenda institucionit për të stimuluar më tej arritjen e rezultateve sa më të larta.</p> <p><i>Annex Nr. 30, Rectorate Decision last Report Course Instructor Evaluation Survey Results</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Epoka përdor një sërë mekanizmesh për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë si p.sh. vlerësimet e studentëve, kolegëve, alumni, partnerëve të IAL, që kanë si objektiv identifikimin e aspekteve për tu përmirësuar dhe evidentimin pikave të forta për tu shpërndarë tek i gjithë stafi.</p> <p>Një tjetër mekanizëm i përdorur për rritjen e cilësisë është edhe organizimi i seminareve akademike, procesi i rishikimit të sillabuseve ku merret në konsideratë edhe mendimi i studentëve, procesi i monitorimit të programeve mësimore, etj të cilat bëhen transparente për të zbatuar një proces sa më të drejtë dhe gjithëpërfshirës. Integrimi i cilësisë së mësimdhënies me politikat mbështetëse për studentët krijojnë mundësi a pasjes së disa strukturave në dispozicion të këtij objekti siç janë për shembull Këshilltari Akademi, Zyra e Regjistrimit të Studentëve, Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe të Diplomuarve etj.</p> <p><i>Annex Nr. 104- Academic Staff Evaluation Survey)</i></p> <p><i>Annex Nr. 27- Policy on Continuous Improvement of Study Program</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e komShetencave të përftuara</p>	<p>Të gjitha grupet e interesuara siç janë studentët aktualë apo ata të diplomuar, stafi akademik dhe administrativ përdorin instrumentat e lartpërmendura për të bërë vlerësimin e performancës së programeve të studimit duke bërë të mundur edhe arritjen e dy objektivave strategjikë: a) vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së pedagogëve nëpërmjet Anketës së Vlerësimit të Instruktorëve të Lëndës nga studentët; b) përfshirjen e studentëve në procesin e vlerësimit të programeve nëpërmjet Student Satisfaction Survey.</p> <p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe të Diplomuarve mban kontakte të vazhdueshme me Alumni duke i angazhuar vazhdimisht në aktivitetet e organizuara nga universiteti dhe duke thithur mendimin e tyre dhe të institucioneve partnere. Shumë prej tyre marrin pjesë në Panairt apo aktivitetet e tjera tematike të cilat organizohet në mënyrë periodike në nga IAL. Në bazë semestrale zhvillohet edhe një rishikim i cilësisë së përmbatjes së lëndëve dhe rezultateve të provimeve përmes sistemit interaktiv të institucionit dhe nga Bordi i provimeve i cili përgatit një raport vjetor.</p>

nga ky program.	<p><i>Annex Nr. 107- Academic Staff Satisfaction Survey</i></p> <p><i>Annex Nr. 58- Last Report related to Student Satisfaction Survey Results</i></p> <p><i>Annex Nr. 95- Decision on the appointment of the study program coordinator</i></p> <p><i>Annex Nr. 96- Company Satisfaction Survey</i></p> <p><i>Annex Nr. 72- Rectorate Decision on the last Exam Board Report</i></p>			
Konkluzione	<p><i>IAL monitoron dhe vlerëson përmes KPSC dhe NjSBC dhe në mënyrë periodike cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese të programit dhe kapaciteteve profesionale të studentëve për të qenë sa më të përgatitur për nevojat e tregut të punës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>IAL siguron një përfshirje të të gjithë aktorëve të jashtëm dhe të brendshëm të sigurimit të cilësisë, falë strukturave të ngritura dhe procedurave të zbatuara në përputhje me Kodin e Cilësisë në Republikën e Shqipërisë, si edhe me Manualin “Per Procedurat dhe afatet për vlerësimin e cilësisë kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”.</p> <p>KPSC dhe NJSBC si strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë mbështeten nga eksperti i jashtëm dhe nga ai ligjor në përmbushjen e detyrave dhe bazohen në përmbushjen e procedurave të sanksionuara në Manualin e Cilësisë</p> <p><i>Annex Nr. 3- Annual Raport of PCQA</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>KPSC dhe NJSBC ka hartuar një rregullore të brendshme për organizimin dhe punën e Komisionit të Përhershëm për garantimin e standarteve të cilësisë, si edhe njësimin e sigurimit të cilësisë. Kjo rregullore është hartuar duke u bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë Nr. 80/2015, datë 22/07/2015 në nenin 103 dhe 104, në Nenin 32 dhe 33 të Statutit të EPOKA, si edhe në Rregulloren për Politikën për Sigurimin e Cilësisë. Kësaj rregullorje i bashkëngjitet edhe rregullorja e kontrollit të cilësisë. Këtyre strukturave edhe procedurave i bashkëngjitet edhe plani i veprimit i hartuar nga KPSC dhe NJSBC për përmbushjen e rekomandimeve të dhëna nga Brodi i Akreditimit për cdo program studimi, në të cilën përcaktohen detyrat për cdo strukturë të IAL</p> <p><i>Annex Nr. 53- Quality Policy</i></p> <p><i>Annex Nr. 44- Regulation On The Organization and Functioning of the PCQA</i></p> <p><i>Annex Nr. 43- Quality Assurance Handbook</i></p> <p><i>Annex Nr. 71- Academic Senate Decision on the Action Plan in response to Accreditation Board Recommendations</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>KPSC dhe NJSBC së bashku me Dekanët e Fakulteteve dhe Drejtuesin e Departamentit janë përgjegjës për çështjet e cilësisë, nëpërmjet monitorimit falë mekanizmave të përmendura më lart.</p> <p>Njësia bazë është përgjegjëse për organizimin dhe zbatimin e të gjithë këtyre formave të monitorimit dhe në bashkëpunim me organet përkatëse të sigurimit të cilësisë bën të mundur analizimin e të dhënave të marra falë bashkëpunimit me zyrat administrative dhe përgatitjen e hapave të caktuar për përmirësimin e problemeve të vërejtura dhe përgjithësimin e praktikave pozitive si përkruhet në statutin e IAL (neni 11, 12, 15, 35 dhe 37).</p> <p><i>Annex Nr. 44- Regulation of the Policies for Quality Assurance)</i></p> <p><i>Annex Nr.1- Statute of Epoka</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset</p>	<p>KPSC zgjidhet nga Senati Akademik dhe anëtarët e tij përfaqësojnë të gjitha fakultetet dhe unionin studentor për të mundur sigurimin e cilësisë në përputhje me kuadrin ligjor</p>

<p>ciklike të vlerësimit duhet të respektojnë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>sic theksohet në <i>Statut</i> nëni 16 pika 1, shkronja a.</p> <p>Për të shmangur pabarazinë ose diskriminimin ndaj personelit dhe studentëve, EPOKA ka hartuar Kodin e Etikës bazuar në legjislacionin përkatës si të administratës publike ashtu edhe Ministrisë së Arsimit. Anëtarët e këtyre organeve përzgjidhen nga stafi akademik me eksperiencë dhe me integritet për të shmangur çdo lloj pabarazie në trajtimin e studentëve apo pedagogëve.</p> <p><i>Annex Nr. 47- Epoka Code of Ethic</i></p> <p><i>Annex Nr. 4- Regulation of the Policies for Quality Assurance</i></p>		
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Për të rritur më tej cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, Epoka angazhon edhe partnerët strategjikë të institucionit apo Alumni përmes zyrës së karrierës në hartimin apo rishikimin e kurrikulave sic theksohet në statut (<i>neni 35</i>). Kjo bëhet me qëllim që të kuptohen sa më mirë nevojat e tregut të punës dhe sugjerimet e mbledhura të integrohen në kurrikulat mësimore</p> <p><i>Annex Nr. 9- Decision of the Rectorate on the Alumni Survey</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>IAL përdor disa mjete për monitorimin e cilësisë dhe përfshin:</i></p> <p><i>a) njësitë akademike nëpërmjet monitorimit periodik; b) personelin akademik; c) studentët në nëpërmjet anketave dhe mekanizmave të ankimimit në proceset e kontrollit të cilësisë së programit të studimit; d) anketimet e kompanive dhe alumni.</i></p> <p><i>Në rastin e evidentimit të problemeve apo praktikave pozitive krijohet mundësia që nëpërmjet formave të njësuarra sic janë raportet apo edhe takimet tematike të informojë palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe të kërkojë përpilimin e masave nëpërmjet departamentit si edhe zbatimin e tyre.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbyset pjesërisht</p>	<p>Përmbyset kryesisht</p>	<p>Përmbyset plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Politikat dhe procedurat që lidhen me sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për të gjitha programet e studimit përfshihen në Manualin e Sigurimit të Cilësisë, Statutin në Rregulloren e Institucionit, por edhe në politika specifike për përmirësimin e cilësisë.</p> <p>Ndërkohë që informacioni lidhur me këto akte ligjore publikohet dhe përditësohet rregullisht në faqen e internetit të institucionit. Po kështu publikohen edhe rregullorja e njësisë, KPSC, si edhe Manuali i Sigurimit të Cilësisë https://aeqi.epoka.edu.al/home.html. Ky informacion i vihet në dispozicion studentëve edhe nëpërmjet Udhëzuesit të Studentëve</p> <p><i>Annex Nr. 27- Policy on Continues Improvement of Study Program</i></p> <p><i>Annex Nr. 78- Smart Student Guide</i></p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>IAL publikon në faqen e universitetit të gjitha vlerësimet e programeve të studimit për akreditimin institucional dhe vë në dispozicion të gjitha vlerësimet nga ASCAL https://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-report-of-the-pcqa-1479-3053.html?lang=EN&dpid=2&t=annual-report-of-the-pcqa&catid=1479&menuid=3053.</p> <p>Vlerësimet e studentëve përpunohen në mënyrë elektronike, ndërsa konkluzionet dhe komentet u bëhen me dijë pedagogëve përkatës pasi ka përfunduar lënda për të ruajtur konfidencialitetin.</p> <p><i>Annex Nr. 59- DoS Annual Report Activity 2021-2022</i></p>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të	<p>Vlerësimet e kryera dhe rezultatet përkatëse për programin pasqyrohen në Raportin Vjetor të Departamentit dhe shoqërohen me një plan veprimi. Duke u nisur nga ky plan veprimi dhe bazuar në një kalendar të brendshëm, NjsBC përgatit plan-veprimin, i cili miratohet nga Senati Akademik së bashku me projekt-buxhetin përkatës duke përfshirë nevojat</p>

evidentuara.	<p>për përmirësimet akademike dhe aktivitetet e departamentëve që synojnë rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të cilësisë akademike.</p> <p><i>Annex Nr. 71-Academic Senate Decision on the Action Plan in response to Accreditation Board Recommendations.</i></p>		
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>Harmonizimi i aktivitetit të strukturave të ndryshme të institucionit me KPSC dhe NjSBC siguron koherencë dhe gjithëpërfshirje në drejtim të sigurimit të cilësisë falë mbledhjes së të dhënave dhe analizës së informacionit duke hartuar sugjerimet dhe përmirësimet përkatëse. KPSC dhe NjSBC hartojnë një raport vjetor ku përfshihen veprimtarinë që këto struktura kanë realizuar për të ndjekur dhe monitoruar aktivitetet e programeve mësimore me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë (https://epoka.edu.al/mat/iqao/2021_2022_Annual_Report_of_PCOA).</p>		
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>Për të përmirësuar më tej metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies IAL zbaton aktivitete të ndryshme si për shembull bashkëbisedime me studentët dhe stafin, thithjen e mendimeve nëpërmjet anketave me studentë, pedagogë, alumni, koMShanitë partnere, vizitat e ekspertëve të huaj akademikë dhe jo-akademikë, organizimi i vizitave studimore dhe kërkimore në terren, si edhe trainime për të kërkuar metodologjitë për ti përmirësuar programet dhe infrastrukturën në dispozicion për të qenë sa më pranë nevojave të studentëve</p> <p><i>Annex Nr. 27- Policy on Continuous Improvement of Study Programs</i></p>		
Konkluzione	<p><i>Prioritetet e vendosura, politikat, proceset e zbatuara, kriteret e përdorura dhe veprimtaritë e zhvilluara për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë publike, transparente për të bërë sa më efektive implementimin e tyre, duke synuar krijimin e një kulture institucionale për arritjen e cilësisë dhe përmirësimin e proceseve për monitorimin e saj.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbushet plotësisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë
 Tel:+355 (04) 22-43423

Website: www.ascal.al

Faqe 90

E-mail: info@ascal.al

Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare”, ofruar nga Universiteti “Epoka”

Pika të forta dhe afirmime:

1. Një numër i lartë pedagogësh që kontribuojnë në modulet e programit, janë të arsimuar / specializuar jashtë dhe ndërmarrin kërkim shkencor cilësor të botuar në revista të rankuara ku në disa raste përfshihen edhe studentët e programit.
2. Institucioni ka një sistem solid për vlerësimin e punës së pedagogëve si nga ana e studentëve në aspektin e mësimdhënies ashtu edhe në bazë të publikimeve për të matur nivelin e kërkimit shkencor.
3. Institucioni ka një infrastrukturë institucionale të mirë-organizuar dhe mbështetje financiare për mobilitetin e studentëve dhe pedagogëve.
4. Mospasja e një praktike mësimore në këtë program njihet si nga stafi edhe nga studentet si një pikë e cila duhet adresuar. Për këtë qëllim duke filluar nga viti akademik 2023-24, programi përfshin edhe praktikën e studentëve si një element të detyruar të programit (Standardi III, kriteri 4).



Rekomandime:

1. Nevojitet një diferencim më i mirë i lëndëve ndërmjet masterit shkencor dhe atij profesional, përveç diferencimit në projektet që u ngarkohen studentëve, si edhe ndryshimit ndërmjet tezës në provimin përfundimtar për masterin shkencor dhe tezës për masterin profesional, duhet të thellohen më tej si në larinë e tematikave të ofruara ashtu edhe në ndryshimin e mësimdhënies për secilën temë (Standardi III, kriteri 1).

Evaluation’s conclusions for the second cycle study program Master of Science in “Political Science and International Relations”, offered by “Epoka” University

Strengths and Affirmations:



1. A significant number of lecturers contributing to the program modules, they are highly educated/specialized abroad and are engaged in high-quality applied scientific research published in ranked journals, sometimes involving program students as well.
2. The institution has a solid system for evaluating the work of lecturers, both from the perspective of students in terms of teaching and based on publications to assess the scientific research level.



3. The institution has well-organized institutional infrastructure and financial support for the mobility of students and lecturers.
4. The lack of a teaching practice in this program is recognized by both staff and students as a point that needs to be addressed. For this purpose, starting from the academic year 2023-24, the program also includes student practice as a mandatory element of the program (Standard III, criterion 4).

Recommendations:

1. There is a need for better differentiation between the content of the research master's and professional master's programs. Besides the differentiation in the projects assigned to students, the distinction between the thesis for the research master's and the thesis for the professional master's should be further emphasized, not only in the diversity of topics offered but also in the teaching approach for each subject (Standard III, Criterion 1).



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
			Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMSHETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

